



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
Administrim Biznesi me profile "Menaxhim", "Marketing",  
"Sipërmarrje dhe Inovacion"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë  
"Universiteti Metropolitan Tirana"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Vita Koja
2. Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Tetor / 2022

**Për Programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i i Shkencave të Administrimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor "Administrim Biznesi" me profile "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 397 datë 22.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR Nr. 397 datë 22.07.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: Bachelor "Administrim Biznesi" me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion" (Viti akademik 2021 – 2022)	Profili "Menaxhim": 14 PAE / 10 PAK Profili "Marketing": 14 PAE / 9 PAK Profili "Sipërmarrje dhe Inovacion": 14 PAE / 10 PAK
18	Numri i studentëve: (2019 – 2022)	36 studentë
19	Komente / të tjera:	-

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i Studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT). Universiteti Metropolitan Tirana, është një institucion jopublik i arsimit të lartë me karakter akademik dhe shkencor, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 357, datë 12.05.2010 me emërtim shkolla private e arsimit të lartë "Universiteti Metropolitan Tirana", Tiranë.

Universiteti zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". UMT është i organizuar në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës si dhe Fakulteti i Ekonomisë.

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, i cili është hapur në vitin akademik 2011-2012 dhe i akredituar për 6 vjet si program studimi Bachelor në "Administrim Biznesi". Më pas me Vendim të Senatit Akademik të UMT-së Nr. 317, datë 20.02.2018, është riorganizuar me tre profile dhe është licencuar me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit Nr. 327, datë 22.07.2019 me afat studimi 3 vite me 180 kredite dhe gjuha e studimit është shqip.

Programi i Studimit, Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë. Misioni i Departamentit është përgatitja, formimi dhe diplomimi i studentëve të aftë në fushën e administrimit, marketingut dhe inovacionit në përputhje me tendencat e tregut të punës.

Në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me objektivat, strategjitë dhe vendimet e këtij programi studimi, vërehet se ky program studimi hartohet dhe ofrohet bazuar fort dhe cilesisht në misionin dhe qëllimet e këtij institucioni.

Misioni i Universitetit Metropolitan Tirana është arsimimi gjithëpërfshirës i studentëve, kualifikimi i tyre, kërkimi shkencor dhe veprimtarive të tjera. Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është pjesë integrale e programeve të studimit të nivelit të parë, që ofron Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit Metropolitan Tirana. Ky program ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit, një departament i konsoliduar dhe me një staf akademik cilësor, që garanton për plotësimin e standardeve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UMT, shpjegohen në mënyrë të detajuar qëllimi i programi si dhe, objektivat e tij, të cilat përputhem plotësisht me nevojat për punësim, kërkesat e tregut, apo nevojat dhe mbështetja që UMT i bën biznesit vendas përmes këtij programi.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion të ofruar nga Universiteti “Metropolitan Tirana” është përgatitur nga ekspertët Prof. Asoc. Dr. Vita Koja dhe Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli të kontraktuar nga ASCAL. Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet shërbimit AMS, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Universiteti “Metropolitan Tirana”. Gjithashtu informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës dy ditore në institucion, si dhe nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Për hartimin e RVJ ekspertët kanë ndjekur një metodologji bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit “Bachelor” në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e planit mësimor sipas aktiviteteve dhe planit mësimor të detajuar, shpërndarjes së krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, mbështetjes së studentëve, sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj.

Vizitat në institucion u kryen në datat 08.06.2022 dhe 09.06.2022. Këto vizita, si dhe i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatoreja teknike e ASCAL Msc. Arjana Alija.

Universiteti “Metropolitan Tirana” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27/09/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 170/13 Prot, datë 28/09/2022. Universiteti “Metropolitan Tirana” përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 157/1 Prot., datë 03/10/2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakordësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion

## I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, që ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit Metropolitan Tirana nuk bie ndesh me interesat kombëtare, ai synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave dhe interesave kombëtare duke kontribuar në një zhvillim ekonomik, shoqëror e kulturor në nivel vendor e kombëtar.</p> <p>Referuar statutit të Universitetit Metropolitan Tirana, misioni i tij është arsimiti gjithëpërfshirës i studentëve, kualifikimi i tyre, kërkimi shkencor dhe veprimtari të tjera. Ky program studimi zhvillon vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie dhe synon, të përgatisë individë të angazhuar dhe me integritet në shoqëri.</p> <p>Në Planin Strategjik të institucionit theksohen objektivat e zhvillimit të programit, ku UMT synon të ofrojë programe universitare me standarde më të larta cilësore, në cikle të ndryshme në përputhje me kornizën shqiptare dhe atë evropiane të kualifikimeve.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ofruar nga UMT Tiranë, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike. Ky program studimi mbështetet në misionin kryesor të UMT-së, për të përcjellë një edukim cilësor, me anë të gërshetimit të një studimi teorik të vlefshëm me praktikën, në funksion të nevojave dhe të dijes së shoqërisë shqiptare.</p> <p>Programi në të gjithë elementët e tij, pasqyron kujdesin dhe kontributin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore, akademike dhe shkencore të vendit. Vizioni i programit është zhvillimi i tij në vazhdimësi, me synim përgatitjen cilësore të specialistëve në fushat e administrimit, marketingut, sipërmarrjes dhe inovacionit, duke iu përshtatur kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, nevojat sociale të vendit dhe ruajtjen e vlerave kulturore.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë përmes njohurive bazë ekonomike që marrin në përfundim të studimeve Bachelor në “Administrim Biznesi”</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, në UMT.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 03: Plani Strategjik i i Zhvillimit të UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 04: Organograma e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 21: Lista e programeve që ofron UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, në përputhje me përparësitë e zhvillimit të vendit.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, zhvillon një sërë aftësish, praktike në menaxhim, marketing dhe inovacion, aftësi të cilat do të nxisin zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar.</p> <p>Nevojat për hapjen e këtij programi janë të studiuara nga analiza që institucioni i ka bërë tregut të punës. Programi u ofron mundësinë studentëve që të fokusohen në përfaqje praktike të drejtpërdrejta të njohurive në fushën e administrimit, marketingut dhe inovacionit. Të diplomuarit do të fitojnë njohuri për t’u përshtatur nevojave të tregut në sektorë dhe aktivitete të ndryshme në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social i vendit.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 03: Plani Strategjik i i Zhvillimit të UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, hartohet dhe ofrohet nga institucioni në përputhje me strategjinë e zhvillimit të tij. Kjo shihet qartë në dokumentat bazë të programit të studimit në shqyrtim. GVJ, referuar dokumentacionit, konstaton se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit, konform objektivave për organizimin dhe zhvillimin e këtij programi në përputhje me Statutin e Institucionit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 03: Plani Strategjik i i Zhvillimit të UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të UMT-së, (<i>Statuti, dhe Rregullorja e Institucionit dhe e Fakultetit</i>) si dhe nga vizita, e zhvilluar në institucion, GVJ arrin në përfundim se: organizimi i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 03: Plani Strategjik i i Zhvillimit të UMT-së</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Administrative, në Fakultetin e Ekonomisë UMT-së dhe qëllimi i këtij programi është të përgatisë profesionistë me kualifikimin e duhur dhe me njohuritë e thelluara në fushën e administrimit, marketingut dhe inovacionit. Ky program, është në përputhje të plotë me drejtimin akademik dhe fushat prioritar të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Departamentit të Shkencave Administrative, që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve. Në dokumentin “<i>Plani strategjik për zhvillimin e Universitetit Metropolitan Tirana</i>”, UMT ka përcaktuar objektivat strategjike të programit. Programi synon formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e administrimit, marketingut dhe inovacionin. Programi synon krijimin e informacionit bazë teorik i shoqëruar për një karriere të suksesshëm profesionale dhe akademike nga njëra anë dhe gjithashtu edhe për krijimin e një profili dhe përshtatjen e njohurive të tyre me nevojat që kërkon tregu.</p> <p>Programi i studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin Metropolitan Tirana, përcakton nevojën e tregut të punës për profesionistë të administrimit të biznesit të marketingut etj. Ky program studimi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përgatisë profesionistë në fushën e aftësisë menaxheriale strtejjsë së biznesit dhe marketingut, menaxhimit të projekteve etj;</li> <li>- të pajisë këta profesionistë me njohuri të avancuara në fushën e studimit, për ti dhënë përgjigje kërkesave të ekonomisë dhe të tregut të punës;</li> <li>- të aftësojë studentët për të menaxhuar biznese të vogla, të mesme dhe menaxher të niveleve të larta në kompani të mëdha;</li> <li>- të mundësojë karrierë të suksesshme dhe kualifikim të mëtejshëm për këta specialistë.</li> </ul> <p><u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë të UMT-së, përgjegjës për programin e studimit, ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, për të përshtatur programin e studimit. Sipas informacionit të përcjellë në RVB-në e hartuar nga institucioni dhe nga takimet e gjatë vizitës në institucion, GVJ, konstaton se në prag të hapjes së programit të studimit, shihen përpjekjet për këto studime në kuadër të disa projekteve, marrëveshjeve të lidhura me institucione dhe kompani të ndryshme për rritjen e mundësive për punësimin e të rinjve, nëpërmjet gjurmimit të studentëve të punësuar etj.</p> <p><u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr. 74: Studim i Tregut për programin e Studimit</i> <i>Aneksi Nr. 81: Rrjeti i Alumnit UMT</i> <i>Aneksi Nr. 82: Lista e Studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al







<p>programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është e orientuar nga nevojat e tregut të punës. Në objektivat strategjike të hapjes së programit të studimit jepen të përcaktuara dhe theksohet se “programi synon përgatitjen cilësore të specialistëve të ekonomisë në fushat e administrimit, marketingut, inovacionit etj.</p> <p>Programi synon të pajisë studentët me kompetencat e nevojshme, për të qenë të aftë, të përballojnë kërkesat e tregut të punës në fushat përkatëse.</p> <p>Ndër kompetencat që studenti duhet të zotërojë në përfundim të programit të studimit janë: kompetencë për studime dhe analiza; kapacitet për të zbatuar njohuritë në praktikë; aftësi për menaxhimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; aftësi për menaxhimin dhe organizimin e marketingut etj.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit Metropolitan Tirana. UMT, është themeluar në vitin 2011, duke zhvilluar veprimtarinë e tij prej një dekade. Referuar dokumentave që shoqërojnë RVB-në, GVJ konstaton se UMT disponon kapacitetet e nevojshme logjistike dhe didaktike për zhvillimin e programit. Gjithashtu, stafi akademik i aktivizuar në program, është me një eksperiencë relativisht të gjatë akademike dhe në përputhje me fushën e programit të studimit. Në FE janë të angazhuar 21 pedagogë me kohë të plotë, 43 pedagogë me kontratë dhe një personel ndihmës.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në Departamentin e Shkencave të Administrimit, përgjegjës për programin studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, për vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga <b>31 pedagogë: 7 pedagogë efektivë (PAE) nga të cilët: 2 Prof. Assoc. 4 Dr., 1 Dr.proc. dhe 24 pedagogë me kontratë (PAK)</b></p> <p>Mbulimi i programit për vitin akademik 2021-2022 sipas profileve rezultoi si më poshtë:</p> <p>Në në profilin “Menaxhim” janë angazhuar gjithsej <b>24 pedagogë</b> nga ku <b>14 pedagogë efektivë (PAE)</b>, nga të cilët:</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 Prof. Assoc.</li> <li>- 8 Dr,</li> <li>- 2 Dr. Proc</li> <li>- 1 Msc,</li> </ul> <p>dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi në përqindje është 14 PAE/10 PAK, 58% PAE.</p> <p>Në në profilin “Marketing” janë angazhuar gjithsej 23 pedagogë nga ku 14 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 Prof. Assoc.</li> <li>- 8 Dr,</li> <li>- 2 Dr. Proc</li> <li>- 1 Msc,</li> </ul> <p>dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi në përqindje është 14 PAE/9 PAK, 61% PAE.</p> <p>Në në profilin “Sipërmarrje dhe Inovacion” janë angazhuar gjithsej 24 pedagogë nga ku 14 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 Prof. Assoc.</li> <li>- 8 Dr,</li> <li>- 2 Dr. Proc</li> <li>- 1 Msc,</li> </ul> <p>dhe pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Mbulimi në përqindje sipas numrit të personelit është 14 PAE/10 PAK, 58% PAE.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe të stafit akademik me kontratë, GVJ konstaton se se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p>Aneksi Nr. 05:VKM e Licensimit të UMT-së</p> <p>Aneksi Nr. 107:Ambjentet për Infrastrukturën e UMT-FE</p> <p>Aneksi Nr. 66: Lista e plotë e Personelit Akademik të UMT-së</p> <p>Aneksi Nr. 67: Lista e plotë e Personelit Ndhmës Akademik të UMT-së</p> <p>Aneksi Nr. 68: Të Dhëna Statistike për Personelin Akademik (PAE-PAK)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodi fikimit të</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është program studimi i ciklit të parë të studimit, i cili organizohet me 180 ETC dhe kohëzgjatje 3 vite akademike.</p> <p>Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit pranë Fakultetit të Ekonomisë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të tyre. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi</p>

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>studimi, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të Ekonomisë. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel e parë Bachelor dhe të dytë Master Profesional dhe Shkencor.</p> <p>UMT siguron zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron nëpërmjet organizimit të tyre në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p>Programi Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, i përket nivelit 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimit. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe shpërndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 50: Rregullore e Departamentit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 958 783 1025">Përmbushet</th> <th data-bbox="783 958 1002 1025">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1002 958 1214 1025">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1214 958 1361 1025">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1025 783 1072"></td> <td data-bbox="783 1025 1002 1072"></td> <td data-bbox="1002 1025 1214 1072"></td> <td data-bbox="1214 1025 1361 1072" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Shkencave të Administrimit, bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion,. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative. UMT ka bazë rregullative dhe akte nënligjore që përcaktojnë rolin dhe detyrat funksionale si të departamenteve, dekanatit, etj. Nga dokumentacioni dhe nga diskutimet gjatë vizitës në UMT, GVJ u informua se Departamenti çdo fillim viti harton planin e aktiviteteve dhe në fund të vitit bëhet bilanci i përmbushjes së këtij plani. Gjithashtu në nivel Departamenti</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>bëhen një sërë analizash si për ecurinë e programit edhe për progresin e studentëve. Në mënyrë periodike analizohet ecuria e procesit të mësimdhënës.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 03: Plani Strategjik i UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 04: Organigrama e UMT-së</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi. Në dokumentin “Evidenca 22”, jepen të listuara bashkëpunimet e fakultetit dhe të UMT-së për realizimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. UMT, ka marrëveshje me shumë institucione si për programin e studimit ashtu edhe në shkallë fakulteti. Nga lista e paraqitur vërehen se pjesëmarrës janë subjekte ekonomike, arsimore, universitete, pushteti lokal, etj. Gjithashtu, UMT ka marrëveshje edhe me universitete jashtë vendit. Institucioni ka zhvilluar një sërë aktivitetesh duke ftuar edhe lektorë të huaj.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 22: Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 72: Lista e Lektorëve të huaj dhe aktiviteteve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UMT dhe Departamenti i Shkencave të Administrimit ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione si për zhvillimin e praktikave mësimore ashtu edhe për realizimin e aktiviteteve të tjera në shërbim të programit mësimor.</p> <p>Në përfundim të vitit akademik, Departamenti realizon analizën e ecurinë e projekteve dhe bashkëpunimeve si edhe për objektivat e programeve të studimit. Rezultatet përmbledhen në raportin vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar të FE-së.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 73: Raporti Vjetor të Aktivitetit Mësimor, Kërkimor dhe Financiar i FE-së</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>UMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi. Në dokumentin “Evidenca 22”, jepen të listuara bashkëpunimet e fakultetit dhe të UMT-së për realizimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. Nga lista e paraqitur, GVJ vëren se UMT bashkëpunon me subjekte ekonomike, universitete, pushtetin lokal, etj. Gjithashtu, UMT vitet e fundit ka bërë marrëveshje me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 23: Lista e Marrëveshjeve në Kuadër të Programeve të FE-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 22: Lista e Universiteteve Bashkëpunuese</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 72: Lista e Lektorëve të huaj dhe aktiviteteve</i></p>




<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Deri tani nuk ka pasur studentë të diplomuar nga programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. Por Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të tjera, ka zhvilluar programe trajnimi për tematika që lidhen me natyrën e programit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 23: Lista e Marrëveshjeve në Kuadër të Programeve të FE-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 72:Lista e Lektorëve të huaj dhe aktiviteteve</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p><b>Standardi II.1</b>  <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar dokumentacionit, rezulton se, programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion ofruar nga Departamenti i Shkencave të Administrimit, pranë Fakultetit të Ekonomisë, në UMT, është i organizuar, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët në program janë karakterizuar sipas veprimtarive formuese dhe kanë të përcaktuar kodin, ngarkesën dhe numrin e krediteve.</p> <p>Nga evidencat rezulton se, programi përmban 29 lëndë, praktikën profesionale si dhe provimin përmbyllës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, realizohet në 3 vite, ndarë në 6 semestra, gjatë të cilit studenti fiton 180 kredite dhe realizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 1824 orë në auditor;</li> <li>▪ 2676 orë punë individuale;</li> <li>▪ 24 orë provimi përmbyllës.</li> </ul>


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 54:Plani Mësimor, Tabela 10</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është një program, që synon arsimimin dhe kualifikimin e studentëve në fushën e administrimit, marketingut, sipërmarrjes dhe inovacionit.</p> <p>GVJ gjykon se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ka në përbërje të tij, lëndë që i ofrojnë studentit njohuri teorike dhe aplikative, duke i shërbyer përgatitjes së profesionistëve në përshtatje me tregun e punës.</p> <p>GVJ konkludon se nëpërmjet realizimit të misionit të tij, ky program studimi, synon formimin e shprehive dhe aftësive në disa drejtime si menaxhimi bizneseve të vogla dhe të mesme, në zhvillimin e strategjive të marketingut, në sipërmarrje etj. Referuar përmbajtjes së programit të studimit, syllabuseve të lëndëve dhe nga takimet që, GVJ pati me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për këtë program studimi, rezultojnë se programi, krijon mundësinë që studentët të marrin njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit, marketingut dhe të sipërmarrjes dhe inovacionit. Referuar materialeve në sistem, hartimi i programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është bazuar në përvojën më të mirë të universiteteve të ngjashme shqiptare dhe ndërkombëtare. Lëndët dhe modulet e programit përcjellin njohuri teorike dhe praktike mbështetur në literaturë bashkëkohore.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 54: Plani Mësimor, Tabela 10</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ mbështetur në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, dhe takimeve me studentë të programit si dhe me stafin akademik të përfshirë në program, është i mendimit se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, nëpërmjet lëndëve që përmban, syllabuseve të tyre, si dhe mënyrës se si organizohen lëndët, synon të jetë i orientuar drejt zhvillimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të lidhura me fushën e administrimit, marketingut, sipërmarrjes dhe të inovacionit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 54: Plani Mësimor, Tabela 10</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën</p>	<p>Bazuar në evidencat si dhe nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ konstaton se, elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile:</p>

e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

**Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, bazohen mbi përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 dhe analizohen si më poshtë:

- a. Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ka 29 lëndë, praktikën profesionale dhe provimin e përmbyllës. Lëndët zhvillohen në 6 semestra me 180 kredite në total. Lëndët organizohen në mënyrë të tillë, ku 27 lëndë, praktika si dhe provimi përmbyllës përmbajnë nga 6 kredite dhe 2 lëndë kanë nga 3 kredite.
- b. Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtareve formuese nga A-E. GVJ, referuar RVB-së si dhe dokumentacionit të depozituar nga institucioni në sistem, konstaton ndarjen e veprimtarive formuese në planin mësimor si më poshtë:
  - **Lëndët bazë** (kategoria A), 5 lëndë me 30 kredite, kanë 16.7% të krediteve;
  - **Lëndët karakterizuese** (kategoria B), 16 lëndë me 96 kredite, kanë 53.3% të krediteve;
  - **Lëndët integrale** (kategoria C), 5 lëndë me 27 kredite kanë 15% të krediteve;
  - **Lëndët plotësuese** (kategoria D), 4 lëndë me 21 kredite kanë 11.7% të krediteve;
  - **Detyrimet përmbyllëse** (kategoria E), 1 lëndë me 6 kredite ka 3.3% të krediteve;

GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese është në përputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24.01.2018.

Gjithashtu, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion/seminar. Hartimi i syllabusit është bazuar në modelin e përcaktuar në *VKM nr. 41, Dt.24.01.2018*. Në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë "Bachelor në Administrim Biznesi" me profilin përkatës (Menaxhim, Marketing, ose Sipërmarrje dhe Inovacion), e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës.

Referenca

*Aneksi Nr. 54: Plani Mësimor, Tabela 10*

*Aneksi Nr. 55: Plani Mësimor sipas Veprimtarive, Tabela 9*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht		Përbushet kryesisht		Përbushet plotësisht	
						X


**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ referuar informacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana, i licensuar me vendim Nr. 357, datë 12.05.2010, zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. UMT është i organizuar në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës si dhe Fakulteti i Ekonomisë.</p> <p>Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë) si dhe ajo bazë (Departamenti i Shkencave të Administrimit) përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Grupi i vlerësimit të brëndshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, i cili është licënsuar me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit Nr. 327, datë 22.07.2019 me afat studimi 3 vite me 180 kredit, është për herë të parë në proces akreditimi.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 53: Dosja e Programit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga RVB, rezulton se institucioni organizon punën për koordinimin e marrëdhënieve të departamentit me studentët. Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligji i Arsimit të lartë nr. 80/2015 është përcaktuar emërimi i koordinatorit të programit. Departamenti propozon dhe përcakton kompetencat e koordinatorit të programit, i cili miratohet nga dekani.</p> <p>Koordinatori i programit, mbikëqyr ecurinë e programit të studimit si dhe mbarëvajtjen e praktikave profesionale të studentëve të viteve të fundit të programeve të departamentit.</p> <p>Koordinatori i programit kryen promovimin e programeve të studimit që ofron njësia bazë, informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore dhe aktivitetet e tjera të organizuara nga njësia bazë.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 39: Përshkrim Pune i Përgjegjës të Programit të Studimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 65: Emërimi i Përgjegjës të Programit të Studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion. FE pranë UMT, vepron brenda kornizave ligjore, në respekt të ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi, Statutit dhe Rregullores së këtij institucioni. Fakulteti aktualisht përbëhet nga 3 njësi bazë: Departamenti i Shkencave të Administrimit, Departamenti Financë-Bankë dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike.</p> <p>Autoriteti drejtues në FE është dekani, ndërsa organet drejtuese kolegjiale janë Komisioni i Përherëshëm dhe Dekanati. Departamenti i Shkencave të Administrimit, krahas programeve të tjera të ciklit të parë</p>






numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

**Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

të studimit, ofron programe të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional dhe Master Shkencor.

Dekani i Fakultetit mban titullin akademik "Profesor i Asociuar Doktor" dhe Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Administrimit, ka gradën shkencore "Doktor".

FE në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij 64 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 21 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 43 staf akademik me kontratë, (PAK).

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave të Administrimit, që është përgjegjës për programin e studimit për vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij 31 pedagogë gjithsej dhe në raportet PAE/PAK është: **(7 PAE / 24 PAK)**, nga këta me grada/tituj shkencore **6 / 20**

Kualifikimi i stafit të Departamentit të Shkencave të Administrimit, si njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit në vitin aktual akademik 2021-2022 është:

<b>PAE:</b>	<b>PAK:</b>
-	4 Prof. Dr.
2 Prof. Asoc.	3 Prof. Asoc.
4 Dr	13 Dr./PhD
1 (Dr. Kadnidat)	4 Msc
<b>7 PAE</b>	<b>24 PAK</b>

Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë, që është përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, janë të përcaktuara në statut dhe në Rregulloren e Fakultetit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë.

Përsa më sipër, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë, plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik. GVJ referuar dokumenteve ku institucioni deklaron të dhënat për stafin akademik efektiv për vitin, 2021-2022 konstaton se numri i stafit efektiv, në njësinë bazë është 7 anëtarë, duke plotësuar kriterin ligjor minimal 7 anëtarë - staf efektiv, për çdo njësi bazë.

Referenca

Aneksi Nr. 66: Lista e plotë e Personelit Akademik të UMT-së, Tabela 2

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se, njësia kryesore dhe ajo bazë, për organizimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, disponojnë informacionet e nevojshme si: rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve etj.</p> <p><u>Referenca</u> Anekset Nr. 53, 54.....deri 61</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se, në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, ndarja sipas veprimtarive formuese e lëndëve është në përputhje të plotë me bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda. Nga shqyrtimi i tabelës 9, rezulton se 29 lëndë, praktika profesionale dhe provimi përmbyllës kanë nga 6 kredite dhe 2 lëndë nga 3 kredite. Programi zhvillohet në 6 semestra. Kohëzgjatja e programit është 3 vjet me nga 60 kredite në vit dhe 180 kredite në total.</p> <p>GVJ konstaton se programi mësimor Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, përmban informacion të plotë për ndarjen e çdo lënde në komponentët leksion/seminar, orët në auditor/jashtë auditorit dhe kreditet për çdo aktivitet.</p> <p>Referuar <i>Rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimit</i> në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara klauzolat për skemën e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët e programit të ciklit të parë të studimit në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral. Konkretisht, vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet sipas rregullit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Provimi i pjesshëm 20 %</li> <li>▪ Vlerësimi vjetor 10 %</li> <li>▪ Detyrë Kursi 10%</li> <li>▪ Provimi final 60 %</li> </ul> <p>Në total studenti mund të përfitojë 100 pikë të mundshme.</p> <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për leksionet detyrimi është në masën 70%</li> <li>- Për seminarët detyrimi është në masën 70 %</li> </ul> <p>Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara. Të gjitha provimet zhvillohen me shkrim.</p>




	<p>GVJ është e mendimit se kjo skemë vlerësimi krijon mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke i shërbyer formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 55: Tabela e Planit mësimor, ndarë sipas veprimtarive</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Syllabuset</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 58: Rregullore e Programit</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të Institucionit, përcaktohen kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve si edhe proceset që lidhen me to. Këto kriteret janë përcaktuar në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe udhëzimeve të MASR.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 58: Rregullore e Programit</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për formatet e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Modeli që përdoret për hartimin e tyre, është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Syllabuset</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, rezultoni se në këtë program studimi nuk ka pësuar ndryshime, por nga viti në vit janë përditësuar syllabuset e lëndëve dhe moduleve të tij.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Syllabuset</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X



#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, GVJ konstaton se programi është strukturuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 180 Kredite të ndara në 3 vite akademike me 60 kredite secili;</li> <li>▪ Orë total 4500, ku, 1824 orë në auditor dhe 2676 orë jashtë auditorit;</li> <li>▪ Për çdo lëndë të përfshirë në programin mësimor është përcaktuar ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë auditorit;</li> <li>▪ Çdo vit akademik përbëhet nga dy semestra me 15 javë mësim;</li> <li>▪ Në vitin e parë zhvillohen 1650, ku, 660 orë në auditor dhe 990 orë jashtë auditorit;</li> <li>▪ Në vitin e dytë zhvillohen 1500, ku, 600 orë në auditor dhe 900 orë jashtë auditorit;</li> <li>▪ Në vitin e tretë zhvillohen 1350 orë, ku, 564 orë në auditor dhe 786 orë jashtë auditorit;</li> </ul> <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është e mendimit se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, ka përputhshmëri, midis emërtimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat do tu mundësojnë studentëve, që vazhdojnë këtë program studimi, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimi. Shpërndarja e lëndëve, sipas viteve të studimit mundëson aftësimin teorik dhe praktik të studentëve, duke filluar në vitin e parë me njohuritë bazë dhe më tej nëpërmjet lëndëve të këtij programi thellohen njohuritë në fushën e administrimit, marketingut dhe të spërmarrjes dhe inovacionit. Praktika profesionale që zhvillojnë studentët në institucione dhe organizata sipas profileve përkatëse, krijojnë mundësi për konkretizimin praktik të njohurive teorike të mara në auditor.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Sipas RVB-së, në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, shpërndarja e lëndëve në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore bën të mundur arritjen e objektivave kryesore formuese të programit. Plani mësimor i këtij programi është strukturuar mbi bazën e një përvoje bashkëkohore ndërkombëtare. Ngarkesa në kredite dhe raportit leksion/seminar në këtë program studimi rezulton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 830 orë leksione</li> </ul>





<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 810 orë seminare</li> <li>▪ 40 orë projekte dhe detyra kursi</li> <li>▪ 120 orë praktika profesionale</li> </ul> <p>Pra raporti teori praktike: 830 orë /970 orë, ose <b>0.86</b> me 1.</p> <p>GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, është i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumenteve raporti leksion/seminar mundëson përfundimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre nga studentët. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve si dhe nga takimi me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra e raste studimore. Gjithashtu, referuar lëndëve në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, GVJ mendon se, ndarja e tyre sipas veprimtarive si dhe raporti teori-praktikë, mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve si dhe mobilitet për punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr.56: Syllabuset</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se programet e lëndëve të programit, përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke rifreskuar lëndët me literaturë dhe botime bashkëkohore.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.56: Syllabuset</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ është e mendimit që programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, me përmbajtjen e tij, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e administrimit, marketingut, sipërmarrjes dhe inovacionit. Në kategorinë B të lëndëve që përgatisin studentët në disiplinën shkencore, përfshihen 16 lëndë, ku studentët marrin dije mbi menaxhimin, marketingun, sipërmarrjen dhe inovacionin në lëndët “Bazat e Menaxhimit”, “Strategji Biznesi”, “Bazat e Marketingut”, “Drejtim Marketingu”, “Menaxhimi i Projekteve dhe Inovacioneve” etj.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve</p>	<p>GVJ, siç është shprehur edhe më sipër, gjykon që programi i studimit përmbajtjen e tij, mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e</p>






në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	tregut e punës, nëpërmjet kompetencave të fituara teorikisht dhe praktikisht.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr.54: Tabela e Planit mësimor për programin e studimit</i>		
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas RVB-së dhe nga takimi me stafin akademik të Departamentit, GVJ konstaton se departamenti ka një bashkëpunim të ngushtë me një sërë organizatash dhe institucionesh për përmirësimin e programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut. Aktualisht nuk ka të punësuar nga ky program, pasi nuk ka studentë të diplomuar.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 23: Lista e Marrëveshjeve në Kuadër të Programeve të FE-së</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>													
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>													
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>												
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi!” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, ofrohet nga DSHA në Fakultetin e Ekonomisë në UMT. Stafi akademik i angazhuar në këtë program është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. GVJ, pas shqyrtimit të të dhënave të paraqitura në dokumentet e dorëzuara në sistem, konstaton se numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2021-2022 është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë angazhuar 31 pedagogë gjithsej (7 PAE / 24 PAK):</p> <table border="1" data-bbox="702 1478 1260 1769"> <thead> <tr> <th><b>PAE:</b></th> <th><b>PAK:</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>-</td> <td>4 Prof. Dr.</td> </tr> <tr> <td>2 Prof. Asoc.</td> <td>3 Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>4 Dr</td> <td>13 Dr./PhD</td> </tr> <tr> <td>1 (Dr. Kandidat)</td> <td>4 Msc</td> </tr> <tr> <td><b>7 PAE</b></td> <td><b>24 PAK</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Mbulimi i programit për këtë vit akademik në përqindje është <b>74% PAE dhe 26% PAK</b>. Ndërsa nga përlllogaritja e ngarkesës në orë mësimore rezultojnë se personeli akademik <b>PAE realizojnë një ngarkesë</b></p>	<b>PAE:</b>	<b>PAK:</b>	-	4 Prof. Dr.	2 Prof. Asoc.	3 Prof. Asoc.	4 Dr	13 Dr./PhD	1 (Dr. Kandidat)	4 Msc	<b>7 PAE</b>	<b>24 PAK</b>
<b>PAE:</b>	<b>PAK:</b>												
-	4 Prof. Dr.												
2 Prof. Asoc.	3 Prof. Asoc.												
4 Dr	13 Dr./PhD												
1 (Dr. Kandidat)	4 Msc												
<b>7 PAE</b>	<b>24 PAK</b>												





studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p><b>1344 orë dhe stafi PAK 480 orë dhe raporti PAE/PAK është 1344/480 ose 74% PAE dhe 26% PAK.</b></p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 01: Statuti i UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 61: CV të Personelit Akademik</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 57: Lista e Personeli të Angazhuarnë programin e studimit "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, Tabela 4</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Ai në marrëveshje me kompani dhe organizata të ndryshme, organizon praktikën profesionale të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje.</p> <p>Nga RVB-ja dhe dokumentacioni i paraqitur, rezulton se institucioni angazhon një pedagog të DESF përgjegjës për këtë program studimi, për të udhëzuar, udhëhequr dhe mbikëqyrur studentët në praktikën profesionale. Në programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje, nuk ka studentë të diplomuar.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 23: Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 50: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 64: Procedura e Përgatitjes së Diplomës</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 88: Dokumentacioni i Praktikës</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi zhvillohen orë laboratorike në disa lëndë, ku institucioni për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, angazhon personelin e përshtatshëm ndihmës mësimor-shkencor.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 108: Të dhëna për Infrastrukturën, Tabela 16</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 67: Lista e Personelit Ndihmës akademik</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 79: Guida e Studentit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, rezulton se ky institucion përkrah aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit në të gjitha njësitë kryesore dhe bazë, duke hartuar edhe një manual mbi procedurat e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të ndryshme për një mësimdhënie bashkëkohore.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 48: Platforma të mësimi online</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 49: Udhëzim për mësimdhënien online</i></p> <p><i>Aneksi Nr.103:Ndërfaqe clasroom e një pedagogu</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar RVB-së, nga shqyrtimi i materialeve të dorëzuara nga institucioni si dhe nga takimet e realizuara nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore, njësia bazë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), zhvillojnë mekanizma monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Mekanizmat dhe njesitë përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënies janë të përcaktuara në rregulloren e UMT-së. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në përdorimin e pyetësorëve për studentët, në grupet e kontrollit me drejtues të departamenteve dhe dekanati dhe raportet për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik dhe ndihmës akademik. NJSBC operon në mbështetje të Rregullores së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 9: Rregullore e NJSBC-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 90: Shembull-Plan Monitorimi për mësimdhënien</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar dokumentacioni i institucionit dhe nga takimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, rezultoi se studentët përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë angazhohen për trajtimin e ankimimeve.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 101: Rregullore e Provimeve</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 113: Procesverbal i Kontrollit në Auditore</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në UMT, si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies është NJSBC, ku veprimtaria e saj është e përcaktuar në rregulloren dhe statutin e UMT-së. NJSBC-ja pasi harton formularët dhe realizon sondazhet e studentëve, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga procesi i monitorimit dhe të përpunuara statistikisht nga zyra e IT-së, përpilon raportin mbi vlerësimin e procesit mësimor. Rezultatet e këtyre raporteve pasi miratohen nga strukturat përkatëse dekanatet dhe rektorati ju bëhen publike edhe pedagogëve.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 19: Pyetësor mbi zhvillimin e mësimin online</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 73: Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>DSHA pranë Fakultetit të Ekonomisë në UMT, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, që po akreditohet, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik. Vlerësimi i performancës realizohet në mbarim të çdo semestri akademik. Promovimi i praktikave më të mira realizohet nëpërmjet trajnimit me lektorë të huaj dhe vendas, organizimit të leksioneve dhe seminareve të hapura etj.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 40: Plani i veprimtarive për viteti 2020-2021 dhe 2021-2022</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 76: Minuta të mbledhjeve të dekanatit</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Bazuar në planin mësimor si dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing Sipërmarrje dhe Inovacion, GVJ konstatoi se në këtë cikël studimesh përdoren forma alternative si leksione, seminarë, detyra kursi, projekte individuale, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, praktika profesionale si dhe provimi përmbyllës ose tema e diplomës. Format e mësimdhënies dhe të mësimnxënies janë të miratuara në rregulloren e Institucionit dhe të Fakultetit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ofrohet i vlerësuar</p>

	<p>me kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) ku, orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 180 Kredite të ndara në 3 vite akademike me 60 kredite secili;</li> <li>• Orë total 4650, ku, 1824 orë në auditor, (nga të cilat 830 orë leksione 810 orë seminare, 40 orë projekte dhe detyra kursi, 120 orë praktika profesionale, 24 orë provimi përmbyllës) dhe 2676 orë jashtë auditorit;</li> <li>• Praktika profesionale 6 kredite</li> <li>• Detyrime përmbyllëse/Diploma 6 kredite</li> </ul> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 50: Rregullore e FE-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr.53: Dosja e Programit</i></p> <p><i>Aneksi Nr.54: Plani Mësimor, Tabela 10</i></p> <p><i>Aneksi Nr.56: Syllabusett</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, rezultoi se stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive dhe diskutimeve, studentët angazhohen edhe në përgatitjen e projekteve dhe të detyrave të kursit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultoi se institucioni, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka investuar në teknologji si dhe ka mundësuar trajnime për stafin akademik. Në funksion të kësaj, institucioni ka pajisur çdo pedagog të Departamentit të Shkencave të Administrimit, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, me bazën didaktike të nevojshme, si kompjutera, videoprojektorë, etj., dhe ka mbështetur stafin në pjesëmarrje në seminare, workshope, konferenca dhe trajnime.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 25: Udhëzues për Planin e Mobilitetit të Stafit Akademik</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 40: Plan pune</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë takimit si dhe referuar CV-së, fushave të ekspertizës dhe, eksperiencës së stafit, rezultoi se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të</p>

<p>metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës. Stafit akademik i DSHA pranë Fakultetit të Ekonomisë të UMT, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Personeli akademik përdor me kompetencë pajisjet në dispozicion të mësimdhënies si dhe ka punuar mjaft në pajisjen e studentëve me tekste dhe cikël leksionesh.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 61: CV e Stafit Akademik</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 72: Lista e Lektorëve të Huaj dhe e Aktiviteteve</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni periodikisht vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. NJSBC harton raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve, i cili është burimi kryesor për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga studentët në funksion të përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 10: Analizë e NJSBC-së, për Pyetësorët e Stafit Akademik</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Për të bërë orët e mësimin më tërheqëse dhe më konkrete stafit akademik i, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përdor metoda interaktive dhe diskutimi me studentët si dhe realizon ndërthurjen e teorisë me praktikën nëpërmjet projekteve dhe detyrave të kursit.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 48: Platformë e Mësimin Online</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 113: Proces Verbal i Kontrollit në Auditor nga Departamenti</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar në takimin me studentët e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafit akademik pranë Departamentit të Shkencave të Administrimit, inkurajojnë autonomi tek studentët dhe sigurojnë marrëdhënie respekti të ndërsjellë. Studentët orientohen dhe inkurajohen të ndërmarrin iniciativa për realizimin e detyrave individuale, rasteve studimore, në organizimin dhe prezantimin e detyrave të kursit etj.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 102: Raport për Metodat Inovative në Procesin e Mësimdhënies</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




**Standardi III.3**


**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme. Në dispozicion të zhvillimit të mësimit nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, në institucion ndodhen auditore për leksione, klasa për seminare, laboratore për zhvillimin e lëndës së informatikës, salla për bibliotekën, zyrë informacioni për studentët si dhe zyra për personelin. Këto mjedise rezultojnë brenda standardeve normale të mirëmbajtjes dhe kushteve higjeno-sanitare.</p> <p>Referuar RVB-së, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, lidhje interneti, kompjutera, videoprojektorë, etj. Gjithashtu mjediset ku zhvillohet procesi mësimor plotësojnë të gjitha kriteret teknike. Mjediset janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe sistem wireless.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 108: Asete Infrastrukturore Akademike-UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB-së, personeli akademik dhe studentët e të gjitha cikleve, përfshirë edhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, shfrytëzojnë internetin, laboratorët e TIK, lidhjen me WI-FI si dhe adresat elektronike për të komunikuar në funksion të përmbushjes së procesit mësimor.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 43: Sistemi Informatik i Menaxhimit të Studentëve</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 45: Ndërfaqe (Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se për shumicën e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në Power Point etj.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 109: Relacioni i Bibliotekës dhe Laboratore Informatike-UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të</p>	<p>Referuar RVB-së dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se, institucioni me qëllim ofrimin e librit sa më pranë studentit, e ka organizuar bibliotekën, e cila disponon 758 tituj dhe funksionon çdo ditë nga ora 9 deri në orën 21. Mjediset e bibliotekës kanë hapësira të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët. Biblioteka funksionon edhe përmes sistemit online.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 109: Relacioni i Bibliotekës dhe Laboratore Informatike-UMT</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ, gjatë kontakteve me studentët dhe stafin akademik të institucionit si dhe referuar RVB-së, konstatoi se në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë bibliotekën digjitale. Në mjediset e bibliotekës ka kompjutera, ku studentët dhe personeli akademik mund të lexojnë bibliotekat online të vënë në dispozicion nga institucioni. Disa adresa funksionale, ku studentët mund të kenë akses në biblioteken elektronike janë: <a href="http://www.thefreelibrary.com">http://www.thefreelibrary.com</a> ;  <a href="http://www.gutenberg.org">http://www.gutenberg.org</a> ;  <a href="http://www.lawlink.coe.int">www.lawlink.coe.int</a> etj.  Studentët mund t'i shfrytëzojnë këto mjedise, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës etj.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 109: Relacioni i Bibliotekës dhe Laboratore Informatike-UMT</i>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga informacioni i siguruar nga RVB-ja, studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, ofruar nga DSHA, pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin Metropolitan Tirana, kanë mundësinë që të shfrytëzojnë laboratorët e informatikës, në funksion të zhvillimit të mësimin në lëndë të ndryshme, si dhe të realizimit të detyrave të kursit etj. Gjithashtu edhe auditorët janë të pajisura me kompjuter, projektorë dhe mjete të tjera, në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 107: Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Referuar RVB, dhe syllabuseve, studentët dhe stafi akademik i brendshëm, janë të pajisur me adresa individuale elektronike me domenin @umt.edu.al, për të mundësuar përdorimin e platformës së sistemit të teknologjisë elektronike në mësimdhënie. Stafi akademik përdor edhe platforma të tjera të personalizuara, për të mundësuar qasjen për studentët në programe të caktuara. UMT, ka aplikuar mësimdhënien online nëpërmjet platformës “GotoMeeting” në periudhën e COVID 19.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 91: Rregullore mbi mënyrën e zhvillimit të primit online</i>
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët e Universitetit Metropolitan Tirana, përdorin sistemin informatik edu4schools për komunikim të brendshëm, për të patur akses në dokumentacionin elektronik. Ky akses i sigurohet nëpërmjet adresës elektronike personale zyrtare me domenin @umt.edu.al. Gjithashtu, përmes portalit studentor, studentët marrin leksionet, detyrat, materiale të tjera si dhe rezultatet e provimeve.




	<u>Referenca</u> Aneksi Nr. 103: Ndërfaqe classroom e një pedagogu		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i depozituar në sistemin e ASCAL, personeli akademik i Departamenti i Shkencave të Administrimit, orienton studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion për përgatitjen e provimit përmbyllës si dhe përzgjedhjen e temës së diplomës për studentët me mesataren e tri viteve mbi 8, sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti.  <u>Referenca</u> Aneksi Nr. 64: Procedura e Përgatitjes së punimit të Diplomës		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Referuar RVB-së dhe nga kontaktet e realizuara, GVJ konstaton se, në nivel institucional, Universiteti Metropolitan Tirana, ka ngritur struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Sipas rregulloreve përkatëse (statuti dhe rregullore e UMT-së, etj.), në institucion funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila koordinon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me njësitë kryesore dhe ato bazë të UMT-së. Gjithashtu për sigurimin e brendshëm të cilësisë NJSBC-ja vepron në bashkëpunim me koordinatorët (Këshilltarët Akademik) të përcaktuar nga DSHA.  <u>Referenca</u> Aneksi Nr. 10: Analizë e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik Aneksi Nr. 98: Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshilltarit Akademik
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Sipas RVB-së, rezulton se në UMT, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Shkencave të Administrimit, janë përgjegjës për sigurimin e cilësinë në mësimdhënie dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. FE nëpërmjet strukturave të tij (përgjegjësat e programeve, përgjegjësat e departamenteve, dhe dekani) në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të UMT-së (zyra e këshillimit të karrierës) nxisin, orjentojnë dhe promovojnë personelin akademik në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në bazë të rregullave

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>dhe kriterëve ligjore të institucionit sipas ekspertizës dhe kualifikimit të personelit. Në vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, janë të përfshirë edhe studentët nëpërmjet pyetësorit. Personeli akademik si dhe studentët janë të vetëdijshëm për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor, me qëllim përmirësimin e saj.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 10: Analiza e pyetësorëve</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 50: Rregullore e FE-së</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 92: Këshilli/Bordi Shkencor</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse si Departamenti i Shkencave të Administrimit dhe NJSBC, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies në Universitetin Metropolitan Tirana. Personeli akademik vazhdimisht trajnohet për përdorimin e softeve dhe programeve specifike për zhvillimin e procesit të mësimdhënies. Gjithashtu DSHA, organizon leksione të hapura me lektorë të ftuar, ekspertë të fushës së administrimit, marketingut sipërmarrjes dhe inovacionit, angazhime në projekte etj.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 102: Raport për metodat inovative në procesin e mësimdhënies</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit konstatoi se institucioni e mbështet personelin akademik në kualifikimin e tij në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Kjo shihet edhe nga numri i pedagogëve me tituj dhe grada në departament. Stafi i DSHA, që mbulon lëndët e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, është në proces të vazhdueshëm kualifikimi sipas fushës individuale kërkimore-shkencore dhe mësimore. Pjesëmarrja në seminare, trajnime, workshope, projekte dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare flasin për përpjekje të vazhdueshme në drejtim të kërkimit shkencor në ndihmë të përmirësimit të mësimdhënies nga stafi akademik i departamentit.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 24: Lista e projekteve të aplikuara nga UMT</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 27: Lista e universiteteve bashkëpunuese</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 72: Lista e lektorëve të huaj</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Sipas RVB-së, UMT ndjek një politikë të mirëpërcaktuar për trajnimin e personelit akademik në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, në funksion të kësaj institucioni mbështet vazhdimisht stafin me trajnime dhe kualifikime në institucione brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet programeve ndërkombëtare si Erasmus, për pjesëmarrje në projekte kërkimore, për botime pa pagesë</p>





	dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore që organizon institucioni në bashkëpunim me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.			
	<i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 22: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Aneksi Nr. 27: Lista e universiteteve bashkëpunuese</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik që është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kjo gjë bazohet në rregulloret e institucionit dhe në angazhimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e procesit të mësimdhënies duke përdorur metoda inovative.			
	<i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së</i> <i>Aneksi Nr. 50: Rregullore e FE-së</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ, konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik, është i angazhuar në realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion si dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, gjë që reflektohet gjatë transmetimit të njohurive tek studentët sipas moduleve. Sipas RVB-së kjo gjë është mundësuar nëpërmjet analizave që bëhen në fund të çdo semestri ku diskutohet efekshmëria e metodave të përdorura si dhe shkëmbimi i përvojave.			
	<i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 73: Rraport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe financiar</i> <i>Aneksi Nr. 93: Procesi i trajnimit të pedagogëve</i> <i>Aneksi Nr. 108: Asete infrastrukurore akademike, Tabela Nr.8</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacioni të depozituar nga institucioni, GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në rregullore të posaçme siç Rregullorja e UMT-së Rregullorja e Fakultetit si dhe Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. Mënyra e vlerësimit jepet e detajuar në syllabuset e







	lëndëve, të cilët janë të publikuara dhe studentët mund të aksesojnë ato në çdo moment.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ, nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga RVB-ja, konstatoi se studentët në zbatim të rregulloreve të sipërpërmendura, informohen nga stafi akademik në fillim të çdo lënde për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale si dhe detyrimet që kanë studentët, informacione këto që studentët mund t'i gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi: Tabela Nr. 14: Forma e syllabusit</i> <i>Aneksi Nr. 42: Modele Proces verbale provimi, listë notash, vërtetime studenti</i> <i>Aneksi Nr. 101: Rregullore e provimeve</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar rregullores së programit dhe syllabuseve, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit të:  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ provimit të ndërmjetëm 20%;</li> <li>▪ pjesëmarrjes dhe aktivizimit 10%;</li> <li>▪ detyrave të kursit 10%;</li> <li>▪ provimit përfundimtar 60%;</li> </ul> Shuma e të cilëve konvertohet në notë. Këto janë forma alternative dhe të ndryshme që i japin mundësi studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara.  <i>Referenca</i> <i>Aneksi Nr. 63: Udhëzim mbi procedurat për zhvillimin e provimeve-FE</i> <i>Aneksi Nr. 101: Rregullore e provimeve</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.6

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ, referuar syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponentë të tillë si pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit, që përbëjnë vlerësimin e vazhduar në masën 40% të vlerësimit total të studentit dhe vlerësimin përfundimtar që realizohet me provimin final




	<p>në masën 60% të vlerësimit total. Të gjithë komponentë reflektohen në vlerësimin final.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 56: Plan programet e lëndëve/syllabuset</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 58: Rregullore e programit të studimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB-së, konstatohet se UMT, për të siguruar transparencën, dhe objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve si dhe për të shmangur subketivizmin, vënë në zbatim sistemin elektronik “edu4scooll”, nëpërmjet të cilës studentët njihen me të gjitha të dhënat dhe rezultatet e provimeve.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 44: Manuale të përdorimit të sistemit informatik</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga RVB-ja si dhe komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi dhe vlerësimi përfundimtar realizohet nga pedagogu kur lënda zhvillohet nga një pedagog, ndërsa kur lënda zhvillohet nga dy pedagogë, vlerësimi bëhet nga një komision, i cili përbëhet nga të dy pedagogët. Teza e provimit hartohet nga pedagogu përkatës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 63: Udhëzim mbi procedurat për zhvillimin e provimeve-FE</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 101: Rregullore e provimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konstaton se provimet realizohen me shkrim në përputhje me Rregulloren e Fakultetit dhe të provimeve, e cila parashikon zhvillimin e provimeve në mënyrë anonime, ku sekretimi bëhet nga sekretaria mësimore. Provimet e sekretuara, pasi korrigjohen nga pedagogu përkatës, shpallen dhe sekretaria bashkon rezultatin me emrin e studentit. Gjithashtu, sipas rregulloreve në fuqi studentët, pasi të marrin rezultatin kanë mundësi të konsultojnë vlerësimin e marrë, për përmirësimin e rezultatit të tyre në të ardhmen. Referuar RVB-së, rezulton se stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, këshillon dhe orienton studentët në lidhje me të gjithë elementet e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me qëllim për të ndihmuar studentët të përmirësohen në mësimnxënies.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr. 63: Udhëzim mbi procedurat për zhvillimin e provimeve-FE</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 101: Rregullore e provimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga një komision i përbërë nga pedagogë të departamentit dhe sekretaria mësimore, për të shmangur kopjimin. Kopjimi në provime si dhe plagjatura e punimeve të studentëve bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës së UMT-së, Rregullores së Universitetit Barleti dhe Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga një komision i përbërë nga pedagogë të departamentit dhe sekretaria mësimore, për të shmangur kopjimin. Kopjimi në provime si dhe plagjatura e punimeve të studentëve bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës së UMT-së, Rregullores së Universitetit Barleti dhe Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion.</p>




	<p><u>Referenca</u></p> <p>Aneksi Nr. 14: Rregullore e Etikës</p> <p>Aneksi Nr. 64: Procedura e përgatitjes së diplomës</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregulloreve përkatëse. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë semestrit, vlerësime këto që janë komponentë të vlerësimit final. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale i komunikohen studentëve bazuar në rregulloren e universitetit, të programit të studimit dhe atë provimeve. Nëse studenti, gjykon se vlerësimi i tij nuk është bërë në bazë të meritës ka mundësinë e ankimit.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p>Aneksi Nr. 101: Rregullore e Provimit</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar në ASCAL nga institucioni, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me mënyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Referuar rregulloreve përkatëse, studentët kanë të drejtën të ballafaqohen me stafin mësimdhënës në lidhje me vlerësimin e provimeve. Mbas këtij ballafaqimi ata kanë të drejtën për të kërkuar rishikim të vlerësimit në rast të paqartësive.</p> <p>Në dokumentacionin e depozituar të institucionit, si rregullorja e institucionit dhe ajo e provimit, GVJ konstaton, se studenti gjithashtu e ka të sanksionuar të drejtën e ankimit për rezultatet. Ankesa i drejtohet komisionit të provimeve brenda 48 orëve nga komunikimi i notës. Ankesat e studentëve fillimisht shqyrtohen nga ky komision, por nëse studenti ka përsëri kontestime, kërkesa shqyrtohet nga komisione të tjera të ngritura të ngritura enkas sipas rregulloreve që lidhen me organizimin e provimeve në UMT.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p>Aneksi Nr. 63: Udhëzim mbi procedurat për zhvillimin e provimeve-FE</p> <p>Aneksi Nr. 101: Rregullore e provimeve</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.7



**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive,	Referuar informacionit të siguruar nga dokumentacioni i depozituar në sistem nga institucioni, rezulton se program i studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing,


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Sipërmarrje dhe Inovacion, i cili përmban 29 lëndë, në tre vite mësimore, garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në funksion të aplikimit të metodave teorike dhe praktike në menaxhim, marketing, sipërmaeje dhe inovacion.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 55: Plani mësimor sipas veprimtarisë (A-E)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, rezultoi se nga mënyra e konceptimit të tij dhe pjesëmarrja në të e veprimtarive dhe disiplinave formuese si gjuha angleze, komunikimi në biznes, marketingu elektronik dhe mediat sociale, praktika profesionale etj, bëjnë që ky program tu garantojë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 54: Plani mësimor, Tabela 10</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, rezulton se kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojë studenti nga ky program janë të shprehura qartë në syllabuset e çdo lënde. Nëpërmjet analizës së rezultateve nga departamenti apo vetë institucioni vlerësohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti nga ky program studimi.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 56: Syllabuset</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit, çdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, të temave kryesore nxjerr në pah çështjet më të rëndësishme. Gjithashtu në këtë seancë pedagogu sqaron dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, venë në dispozicion literaturën dhe shpallin oraret e konsultimit.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 63: Lista e lektorëve të huaj dhe aktiviteteve</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe dokumentacionit të depozituar në sistem, rezulton se për studentët e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, janë organizuar leksione të hapura me lektorë nga personeli akademik i brendshëm dhe lektorë të ftuar për të diskutuar për zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë.</p> <p><u>Referenca</u></p>

	<i>Aneksi Nr.72: Udhëzim mbi procedurat për zhvillimin e provimeve-FE</i>
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies, bazuar në rregulloren e programit, organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim të njohurive të siguruar nga teoria në laboratorë dhe praktikat profesionale.  <u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr.57: Ngarkesa totale e Personeli Akademik, Tabela 4</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Referuar RVB-së dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit, rezulton se personeli akademik i DSHA, gjatë orëve të procesit mësimor mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara të fushës së administrimit, marketingut, të sipërmarrjes dhe inovacionit nëpërmjet organizimit të projekteve dhe detyrave të kursit.  <u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr.62: Personeli Akademik dhe Administrativ, Tabela 2</i>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Referuar RVB-së, në Universitetin Metropolitan Tirana, personeli akademik mbështet idetë inovative dhe shkencore të studentëve, për ti bërë ato të zbatueshme, në zgjidhjen e problemeve në sektorët e administrimit të biznesit, marketingut, sipërmarrjes dhe të inovacionit.  <u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr.93: Procesi i trajnimit të pedagogëve mbi metodat e mësimdhënies</i>
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga informacioni i siguruar nga dokumentacioni, rezultoi se institucioni, mbështet idetë inovative të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion. Departamentet në UMT i krijojnë mundësi studentëve të përfshihen në projekte kërkimore dhe studime të avancuar nëpërmjet bashkëpunimeve.  <u>Referenca</u> <i>Aneksi Nr.15: Lista e start up dhe Inkubatori</i> <i>Aneksi Nr.24: Lista e projekteve të aplikuara në UMT</i> <i>Aneksi Nr.27: Lista e Universiteteve Bashkëpunues</i>
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton se institucioni bën përpjekje për të ndërthurur format e mësimdhënies me institucione bashkëpunuese. Kështu, nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë të huaja si dhe projektit ERASMUS, ka mundësuar mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve.  <u>Referenca</u>






	Aneksi Nr.15: Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve dhe stafit		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të FE përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, cikli i parë i studimeve Bachelor përmbillet me provimin final ose me punim diploma, për ata studentë me mesatare mbi 8. Sipas procedurës së përmbylljes së studimeve bachelor në UMT, studenti duhet të ketë marrë 180 kredite në tre vite studimi dhe mbrojtja e provës finale bëhet në tre sezona verë, vjeshtë dhe dimër, Sezoni i diplomimit shpallet nga rektori, ndërsa data përcaktohet nga dekani. Provimi përmbyllës apo mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni i përbërë nga tre anëtarë nga personeli akademik PAE, i cili propozohet nga departamenti dhe miratohet nga dekani i fakultetit.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 02: Rregullore e UMT-së Aneksi Nr. 64: Procedura e përgatitjes së diplomës</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit të studimeve Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, rezultoi se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të provimit final dhe përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës sipas rregullores së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar dokumentit të procedurës së diplomimit, studentët e programit të Studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, që nuk plotësojnë kriterin e mesatares për mbrojtjen e diplomës, i nënshtrohen provimit final, i cili bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike të tyre. Komisioni për vlerësimin e provimit final të programit të studimit, bazohet në tezat e provimit të hartuara bazuar në programin e provimit të formimit</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 64: Procedura e përgatitjes së diplomës</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit, rezulton se personeli akademik i DSHA, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion orienton dhe ndihmon studentët në përgatitjen e provimit final.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 64: Procedura e përgatitjes së diplomës</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ është i mendimit se institucioni ka kapacitetet e duhura për ti asistuar studentët në përgatitjen e punimit të temës sipas fushës së studimit, duke i krijuar mundësi në grumbullimin e të dhënave sekondare apo informacioneve në funksion të temës, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione partnere. Në këtë program studimi nuk ka studentë të diplomuar.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr.101: Rregullore e Provimeve</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës i temës së diplomës, caktohet nga stafi i brendhëm i departamentit në përputhje me fushën e ekspertizës së temës. Udhëheqësi i diplomës mbështet studentin gjatë strukturimit të temës si nga ana e përmbajtjes ashtu edhe ajo formale, bazuar në rregullat e shkrimit akademik.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 64: Procedura e përgatitjes së diplomës</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në procedurën e diplomimit dhe rregulloren e programit bachelor në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion, sipas përgjigjes së dhënë apo prezantimit të punimit studenti vlerësohet me notë dhe fiton kreditet e plota sipas planit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Siç është e parashikuar në <i>nenin 91 të ligjit</i> Nr. 80/2015, në përfundim të studimeve, studentët, që kanë plotësuar të gjitha detyrimet e programit mësimor si dhe detyrimet financiare, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit ku bën pjesë departamenti përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit si dhe nga Rektori i UMT-së. Modeli i diplomës dhe i suplementit janë hartuar në përputhje me aktet rregulluese të miratuara nga Ministria e Arsimit.</p> <p><u>Referenca</u> Aneksi Nr. 59: Modeli i diplomës Aneksi Nr. 60: Modeli i suplementit</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të parë, çdo student i vihet në dispozicion lista e notave dhe suplementi i diplomës. Ndërsa një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit i vihet në dispozicion studentit, vetëm me kërkesë të tij.</p> <p><u>Referenca</u></p>

	<p><i>Aneksi Nr. 59: Modeli i diplomës</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 60: Modeli i suplementit</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni për studentët i plotësuar në kompjuter apo me dorë, ruhet për një kohë të pacaktuar nga institucioni nëpërmjet sekretarive mësimore të fakulteteve, si në hard-copy edhe në formë elektronike. Institucioni paraqet rast pas rasti informacione për studentët nëse kërkohen.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi Nr.95: Rregullore e Sekretarisë</i></p> <p><i>Aneksi Nr.111: Rregullore e Arkivës</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi IV.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në bazë të RVB si dhe informacioneve të marra nga vizita në institucion, GVJ konstaton se zyra e Burimeve Njerëzore në UMT, e cila është nën varësinë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të anëtarëve të personelit akademik, ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ në këtë institucion. Të dhënat mbledhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe të legjislacionit për ruajtjen e të dhënave personale.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Këto dosje përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: CV, dokumentin e identifikimit, pozicionin e punës, diplomatat dhe listat e notave, gradat shkencore, dëshmitë e gjuhëve të huaja, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, kontratën e punës, etj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






	<p>Gjithashtu GVJ konstaton se informacioni për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Shkencave të Administrimit, përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><a href="https://umt.edu.al/stafi-administrativ">https://umt.edu.al/stafi-administrativ</a></p> <p><i>Aneksi 51 Struktura organigrama e FE.pdf</i></p> <p><i>Aneks/Shtojce Agjenda për vizite Bsc Administrim Biznesi me profile, Universiteti Metropolitan Tirana -Tabela nr. 4 dhe tabela 12.1.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik në UMT janë të përcaktuara në dokumentat: Statuti i UMT, Pjesa e Tretë; Rregullorja e UMT, Neni 11, 12; Udhëzim mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik të miratuar nga Senati Akademik Nr. 850/1 datë 11.11.19. Këto procedura hartohen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Në dokumentat e sipërcituara janë përcaktuar: kërkesat e përgjithëshme dhe specifike për të qenë punonjës i UMT, procedurat e përzgjedhjes së kandidatit, shpallja dhe procesi i konkurimit, mënyra e vlerësimit, etj. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit dhe i bën ato publike. Kjo zyrë përgatit përshkrimet e punës për çdo pozicion, harton dhe shpall konkurset për plotësimin e vendeve vakante, harton kontratat për punonjësit në respekt të Kodit të Punës, kujdeset për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve, mban evidenca për performancën e tyre etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ u njoh me këto procedura gjatë vizitës në institucion nëpërmjet përfaqësuesit të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Konstatohet që kërkesat për personel akademik vijnë nga njësi bazë, bazuar tek planet mësimore dhe ngarkesa mësimore, miratohen nga njësi kryesore dhe aprovohen nga Rektori. Kriteret specifike për personelin akademik për këtë program studimi përcaktohen nga Departamenti i Shkencave të Administrimit me miratim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë. Më pas ato përcillen në Rektorat për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të rekrutimit. Këto kritere kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit vakant dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit. Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Kjo gjë u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimet që GVJ pati me pedagogët si dhe drejtuesit e institucionit.</p> <p>Në faqen e web-it të institucionit <a href="https://umt.edu.al/puno-ne-umt">https://umt.edu.al/puno-ne-umt</a> gjenden njoftimet për vendet vakante të cilat përmbajnë kërkesat e përgjithëshme dhe specifike përkatëse sipas vendeve vakante të shpallura.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p>




	<p><i>Aneksi 29 Udhëzim mbi politikat e procedurat e punësimit të personelit akademik në UMT.pdf</i></p> <p><a href="https://umt.edu.al/stafi-administrativ">https://umt.edu.al/stafi-administrativ</a></p> <p><a href="https://umt.edu.al/puno-ne-umt">https://umt.edu.al/puno-ne-umt</a></p> <p><a href="https://umt.edu.al/image.ashx?i=1620143.pdf&amp;fn=Posti_FSHKIT.pdf">https://umt.edu.al/image.ashx?i=1620143.pdf&amp;fn=Posti_FSHKIT.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në UMT zhvillohen në përputhje me Udhëzimin mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik të miratuar nga Senati Akademik Nr. 850/1 datë 11.11.19, si dhe bazuar në Rregulloren dhe Statutin e UMT. Udhëzimi përcakton procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, mënyrën e shpalljes dhe realizimit të konkursit dhe mënyrën e vlerësimit. Për rekrutimin e stafit ngrihen komisionet ad hoc, rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të të cilit caktohen në aktet e brendshme të UMT (Statuti i UMT). Këto komisione kanë përfaqësues të departamentit përkatës ku ka nisur kërkesa për staf të ri, 1 përfaqësues të dekanatit dhe 1 përfaqësues të rektoratit. Fazat nëpër të cilat kalon procesi i rekrutimit janë përgjithësisht të njëjta, ku në fillim publikohen vendet vakante në faqen e web-it të UMT me kriteret e përgjithëshme dhe specifike dhe më pas bëhet përzgjedhja e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe intervistohen kandidatët nga komisioni ad hoc i ngritur specifikisht në përputhje me vendin vakant.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa dosje të procedurave të rekrutimit të personelit pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dhe konstatoi se këto procedura janë ndjekur për të gjithë stafin e rekrutuar. GVJ konstaton se UMT e ka prioritet përzgjedhjen e stafit të kualifikuar dhe vlerëson se përbërja e stafit në këtë institucion është një nga pikat e veta më të forta.</p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 29 Udhëzim mbi politikat e procedurat e punësimit të personelit akademik në UMT.pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për	GVJ konstaton se UMT ka krijuar kushte shumë të mira infrastrukturore për personelin, që ai të kryejë të gjitha detyrat e tij në mënyrë sa më profesionale. GVJ vizitoi zyrat dhe mjediset e tjera të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>punës dhe vëren se ato janë komode, të pajisura me kompjutera personalë për stafin, rrjet interneti, sistem kondicionimi, etj, për të krijuar një mjedis optimal për realizimin e detyrave të stafit. Gjithashtu GVJ vizitoi ambientet ku zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi dhe konstaton se ato kanë një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Klasat dhe laboratorët ofrojnë kushte shumë të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të UMT. Të gjitha këto ambiente janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjutera, printera, skanera, etj.) si dhe mbulohen nga rrjeti wireless që ofron Internet për stafin dhe studentët.</p> <p><i>Referenca</i></p> <p><i>Aneksi 107Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 108Asete infrastrukturore kademike - UMT.pdf</i></p> <p><i><a href="https://umt.edu.al/mjediset-dhe-laboratoret">https://umt.edu.al/mjediset-dhe-laboratoret</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Strategjinë e Zhvillimit të UMT janë cilësuar si prioritate zhvillimi i vazhdueshëm i kushteve dhe aftësive mësimdhënëse të stafit akademik, fuqizimi dhe mbështetja me fonde të qendrës kërkimore të UMT, si dhe fuqizimi dhe zgjerimi i partneriteteve vendase dhe të huaja. Me qëllim zbatimin e këtyre strategjive, GVJ u informua në takimin me pedagogët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile, se UMT vazhdimisht i ofron stafit mundësi kualifikimi dhe zhvillimi profesional të vazhdueshëm. Gjithashtu këtë gjë e konfirmoi edhe përfaqësuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore i cili theksoi se kjo zyrë mbështet stafin akademik për trajnime dhe kualifikime të ndryshme që i shërbejnë rritjes profesionale të tyre.</p> <p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara GVJ konstaton se UMT ka mbështetur stafin akademik për të marrë pjesë në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+. Gjithashtu UMT i ka mundësuar stafit akademik trajnime të ndryshme nëpërmjet projektit Bolonja. Në kuadër të rritjes së nivelit të kërkimit shkencor UMT ka mbështetur financiarisht personelin akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 3 Plani Strategjik i UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 25Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik në kuader të erasmus+.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 28Lista e shkëmbimeve ndërkombetare të UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 93Procesi i trajnimit të pedagogeve mbi metodat e mësimdhënies.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Mbështetur në dokumentat e shqyrtuara, në RVB si dhe nga informacionet e marra në takimet me pedagogët dhe drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ konstaton që institucioni nxit dhe mbështet zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies si dhe përdorimin e teknologjive të reja.</p> <p>Përveç ofrimit të mundësive për mobilitete dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore me partnerë të huaj të stafit akademik të përmenduar në kriterin më sipër, UMT i ka mundur stafit akademik edhe ofrimin e trajnimeve në lidhje me përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Pasi shqyrtoi dokumentat: “Metodat inovative të mësimdhënies që përmirësojnë angazhimin e studentëve”; “Manuali i përdorimit të sistemit informatik edu4schools”; “Kërkimi shkencor dhe veprimtaritë krijuese dhe të inovacionit në UMT”, GVJ konstaton se UMT ka zhvilluar këto aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtjshëm profesional të personelit akademik :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnime për implementimin e sistemit elektronik për përdorimin e platformës së menaxhimit të programit të studimit edu4schools.</li> <li>- Trajnime për shkrimin dhe aplikimin në projekte të kërkimit shkencor nga AKKSHI.</li> <li>- Leksione të hapura nga lektorë të huaj dhe vendas.</li> <li>- Veprimtari inovative, trajnimi, workshop, vizita studimore të tilla si: Ditët e kërkimit shkencor në Fakultetin e Ekonomisë; Java e Inovacionit dhe Karrierës; Vizitë studimore në Drejtorinë e Shërbimeve të Tatimpaguesve në Tiranë; Vizitë studimore në AgroBlend; Bashkëpunim me Ring Center.</li> <li>- Etj.</li> </ul> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 102Raporti per metodat inovative në procesin e mësimdhënies.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 103Ndërfaqe classroom e një pedagogu.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 93Procesi i trajnimit të pedagogeve mbi metodat e mësimdhënies.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 92Keshilli bordi shkencor.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 72Lista e lektoreve të huaj dhe aktiviteteve - FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 49Udhëzim mbi mesimdhënien online.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 44Manual përdorimi i sistemit informatik të studentëve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Anekset_shtese.zip: Tabelat Bachelor në Administrim Biznesi me profile), si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si dhe Departamenti i Shkencave të Administrimit, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për</p>

përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM 418, Maj 2017) dhe nivelin e kualifikimit të stafit (Tabela 6.1 Cilësia e stafit për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi dhe Tabela 7 Stafit sipas kualifikimit).

Gjatë vitit 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion” janë angazhuar përkatësisht sipas profileve:

- Profili “Menaxhim” 14 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:
  - 4 pedagogë me titullin akademik Profesor;
  - 5 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar;
  - 11 pedagogë me gradën Doktor;
  - 2 pedagog në proces doktorature;
  - 2 pedagogë me kualifikimin MSc.
- Profili “Marketing” 14 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:
  - 4 pedagogë me titullin akademik Profesor;
  - 4 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar;
  - 11 pedagogë me gradën Doktor;
  - 2 pedagog në proces doktorature;
  - 2 pedagogë me kualifikimin MSc.
- Profili “Sipërmarrje dhe Inovacion” 14 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK). Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:
  - 4 pedagogë me titullin akademik Profesor;
  - 5 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar;
  - 11 pedagogë me gradën Doktor;
  - 2 pedagog në proces doktorature;
  - 2 pedagogë me kualifikimin MSc.

Në bazë të dokumentave të dorëzuara (Tabela 12.1 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik të Programit Bachelor në Administrim Biznesi Profili: Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion) personeli akademik efektiv mbulon rreth 74% të orëve (1344 orë nga 1824) të programit Bachelor në Administrim Biznesi me profile dhe personeli akademik me kontratë 26% të orëve (480 orë nga 1824) të tij.

Evidenca

	<p><i>Aneksset_shtese.zip: Tabelat Bachelor në Administrim Biznesi me profile</i></p> <p><i>Aneksi 69Te dhëna për mbulimin e lëndeve me personel akademik - Tabela Nr. 3.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 68Te dhëna statistikore të personelit akademik PAE dhe PAK - Tabela nr. 1.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 66Lista e plotë e personelit akademik me kohë të plotë, me kohë të pjeshme-FE-Tabela nr. 2.pdf</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi mjediset e UMT dhe konstatoi se institucioni disponon mjedise të përshtatshme dhe komode për zhvillimin e procesit mësimor në tërësi. GVJ u informua që Zyra e Financës është struktura që disponon inventarët e aseteve të institucionit, si dhe planifikon dhe realizon në përputhje me buxhetin e miratuar shtimin apo përmirësimin e këtyre mjedisëve. Bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës (Infrastruktura për Fakultetin e Ekonomisë), konstatojmë se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në dy godina: Godina 1 me sipërfaqe 2347 m<sup>2</sup> dhe Godina 2 me sipërfaqe 2490 m<sup>2</sup>, të cilat ofrojnë një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të të gjitha programeve të studimit dhe numrin e studentëve në to. Në 2 godinat e UMT gjenden sallat e leksioneve, sallat e seminareve, 6 laboratorë informatike dhe biblioteka.</p> <p>GVJ u informua që në planet strategjike të UMT është edhe ndërtimi i kampusit të ri universitar, i cili është në proces. Me këtë investim instituoni synon të përmirësojë edhe më shumë infrastrukturën në shërbim të procesit mësimor në tërësi.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 107Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 108Asete infrastrukturore kademike - UMT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi ambjentet ku zhvillohej procesi mësimor për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”. GVJ konfirmon se klasat dhe laboratorët ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me kompjuter, videoprojektorë, sisteme audio,</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>lidhje interneti wireless falas për studentë dhe pedagogët, që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sistemet e teknologjisë së informacionit që i shërbejnë realizimit të programit të studimit (edu4schools). Studentët mund të përdorin edhe bibliotekën për akses në internet, ose të përdorin kompjuterat që ndodhen në të për të punuar për detyrat e kursit apo punime të tjera në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Për sa u tha më sipër, GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat, labororet, etj) të UMT janë në mbështetje të realizimit të objektivave formues të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 107Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 108Asete infrastrukturore kademike - UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 44Manual përdorimi i sistemit informatik të studentëve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe në kriterin 1 të këtij standardi, GVJ konstaton se institucioni disponon 6 laboratorë të teknologjisë së informacionit, në të cilat zhvillohen orët laboratorike për programet e studimit që kanë të parashikuara orët e laboratorit dhe përdorimin e programeve aplikative të fushave të ndryshme të studimit. Përveç programeve që lidhen me fushën e Informatikës, studentët përdorin në laborator edhe programe që lidhen me lëndë të tjera të tilla si ato të Financës, Kontabilitetit, Menaxhimit e Burimeve Njerzore, etj. Gjithashtu në shërbim të studentëve është edhe një sallë interneti.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 107Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</i></p> <p><a href="https://umt.edu.al/mjediset-dhe-labororet">https://umt.edu.al/mjediset-dhe-labororet</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”, praktika profesionale/mësimore është 150 orë, nga të cilat 120 orë studenti i realizon në auditor dhe 30 orë janë studim individual i studentit. Mbështetur në infrastrukturën e institucionit, të cilësuar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, GVJ konkludon se institucioni i ofron studentëve mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p>Në dokumentin (Aneksi 88 Seti i dokumentacionit të praktikës për programin e studimit.pdf) jepen udhëzimet për kohëzgjatjen e praktikës dhe periudhën e zhvillimit, subjektet ku do të zhvillohet si dhe programin e saj. Gjithashtu në të janë paraqitur edhe dokumentat e raportimit që student duhet të plotësojë në përfundim të saj. Në këtë kuadër, konstatojmë që UMT ka nënshkruar 68 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja, si dhe kompani dhe institucione të sektorit publik dhe privat (Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE), disa prej të cilave kanë si qëllim</p>





	<p>zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të programeve të studimit që ofrohen në UMT. Këto institucione i ofrojnë mundësi shumë të mira studentëve të praktikojnë konkretisht njohuritë e fituara sipas profileve dhe fushave të tyre të studimit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p>Aneksi 54Plani mësimor tabela 10.pdf</p> <p>Aneksi 22Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit dhe antarësimit në rrjete.pdf</p> <p>Aneksi 23Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE.pdf</p> <p>Aneksi 88Seti i dokumentacionit të praktikës për programin e studimit.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka bibliotekën e saj me dy salla (dokumenti “Infrastruktura e Fakultetit të Ekonomisë për programin e studimit”), të pozicionuar në katin e parë të Godinës 1. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mjediset e saj, si dhe fondin fizik të literaturës që kjo bibliotekë disponon. Konfirmojmë që kjo bibliotekë ofron mundësi të barabarta në përdorimin e saj, për të gjithë studentët si dhe për stafin akademik. Oraret e bibliotekës janë të alternuara paradite dhe mbasdite për ti dhënë mundësi aksesit studentëve dhe stafit sipas mundësive dhe në përshtatje me oraret mësimore. Materialet e saj mund të përdoren në mjediset e brendshme të bibliotekës ose të huazohen nëpërmjet shërbimit që ofron ajo.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara (Aneksi 109 Relacion i bibliotekës (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore informatike - UMT.pdf_Inventari i Bibliotekës së UMT) GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj rreth 758 botime të ndryshme: libra, revista shkencore, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. Gjithashtu konstatojmë se edhe në dispozicion të këtij programi studimi ka një fond të bollshëm të literaturës që nevojitet për të mbuluar të gjithë veprimtarinë mësimore me literaturë të detyruar dhe ndihmëse (Aneksi 110 Lista e botimeve.pdf_Lista e publikimeve të stafit akademik efektiv të FE-UMT).</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p>Aneksi 107Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</p>






	<p><i>Aneksi 108 Asete infrastrukurore kademike - UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 109 Relacion i bibliotëks (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore informatike -UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 110 Lista e botimeve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse e kemi evidentuar edhe në Standardin III.3 të këtij raporti, gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, në takimet me studentët dhe stafin akademik të institucionit si dhe referuar RVB-së, GVJ u informua se personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë bibliotekën dixhitale në funksion të nevojave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në mjediset e bibliotekës ka kompjutera, ku studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë bibliotekat online të vëna në dispozicion nga institucioni. Disa adresa funksionale, ku studentët mund të kenë akses në bibliotekat elektronike janë:</p> <p><a href="http://www.thefreelibrary.com">http://www.thefreelibrary.com</a>;</p> <p><a href="http://www.cobis.al">http://www.cobis.al</a>;</p> <p><a href="http://www.accessmylibrary.com">http://www.accessmylibrary.com</a>;</p> <p><a href="http://www.gutenberg.org">http://www.gutenberg.org</a>;</p> <p><a href="http://www.lawlink.coe.int">www.lawlink.coe.int</a> etj.</p> <p>Gjithashtu kompjuterat në bibliotekë janë të pajisur me programe kompjuterike që ju jep studentëve mundësinë e shfrytëzimit pa kufizime, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës etj. Megjithatë GVJ konstaton se numri i tyre është i vogël dhe sugjeron shtimin e kompjuterave në bibliotekë për ti shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Tabelat Bachelor në Administrim Biznesi me profile.pdf – Tabela 16</i></p> <p><i>Aneksi 109 Relacion i bibliotëks (hard copy dhe elektronike) dhe laboratore informatike -UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 107 Ambjentët për infrastrukturën e UMT-FE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të fondit të bibliotekës GVJ u informua që UMT parashikon fonde çdo vit për shtimin e literaturës në bibliotekë, mbështetur kjo edhe tek informacioni i paraqitur në RVB dhe të marrë gjatë vizitës në institucion. Megjithatë në buxhetin e vitit 2021 – 2022 nuk ka një ndarje të qartë të fondit të alokuar për pasurimin e bibliotekës. Gjithashtu GVJ nuk konstaton ndonjë dokument që të paraqesë planin e detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës, në bazë të kërkesave të njëjste bazë apo kryesore. GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës së bibliotekës.</p> <p>Megjithatë, GVJ u informua nga punonjësi i bibliotekës, se UMT ka bërë përpjekje dhe është në përfundim të procesit të lidhjes së marrëveshjes me RASH për të pasur akses në bibliotekën online <a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a>. Gjithashtu në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UMT ka me institucionet partnere, ka krijuar edhe</p>

	mundësinë që të shfrytëzohen infrastrukturat e tyre si dhe burimet e tyre të literaturës.  <i>Evidenca</i> <i>Aneksi 96Buxheti i UMT-së.pdf</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve nga ora 9.00 paradite deri në orën 21.00 të mbrëmjes. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një fashë të gjërë orari, pa ju cënuar oraret e zhvillimit të procesit mësimor.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstaton që UMT përdor sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit “edu4schools”, Portalin e Studentit dhe “gotomeeting”. Zyra e Sekretarisë Mësimore administrohet informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim, në përputhje me Rregulloren e UMT Neni 32 dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore Neni 8. Sekretaria mban regjistrat bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre (themeltar), regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo certifikatave të dhëna mbi diplomën e marrë bashkë me suplementin e diplomës. Regjistrat e studentëve janë të plotësuar në formë të shkruar dhe elektronike. GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në institucion dhe dosjet personale të studentëve. dhe konstatoi që të gjithë të dhënat e studentëve në këtë program studimi në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt.  <i>Evidenca</i> <i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Aneksi 95Rregullore e Sekretarisë.pdf</i> <i>Aneksi 43Informacion informatik i menaxhimit të studenteve.pdf</i> <i>Aneksi 45Ndërfaqja Administrator, Pedagogu, Sekretaria, Studenti.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe	Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në UMT, në takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, ashtu sikurse e kemi përmenduar edhe në Standardin IV.1, GVJ u informua se kjo zyrë është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të UMT. Në takim me përfaqësues të kësaj zyre GVJ u

<p>partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>interesua të dinte nëse ka ndonjë rregullore mbi bazën e të cilës vepron zyra e Burimeve Njerzore, meqënëse në dosjen e vetë vlerësimin nuk gjendet një e tillë. GVJ u informua që kjo zyrë është nën varësinë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, procedurat e punës së saj janë të standardizuara dhe miratura nga drejtuesi përkatës. GVJ konstaton që kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditësohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• CV e personelit (për personelin akademik, CV shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore);</li> <li>• Fotokopje e pasaportës / ID dhe adresa e banimit;</li> <li>• Formular vetëdeklarimi / dëshmi penaliteti;</li> <li>• Pozicioni i punës;</li> <li>• Diplomat;</li> <li>• Gradat shkencore / titujt akademikë;</li> <li>• Libreza shëndetsore;</li> <li>• Kualifikime të tjera / informacione shtesë.</li> </ul> <p><i>Evidenca</i> <a href="https://umt.edu.al/stafi-administrativ">https://umt.edu.al/stafi-administrativ</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse e evidentuam edhe më sipër, UMT përdor sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit “edu4schools”. GVJ konstaton që në këtë sistem kanë akses të dedikuar të gjithë studentët si dhe personeli akademik dhe administrativ i institucionit, sipas nivelit dhe njësive ku ata shërbejnë. Secili prej tyre ka ndërfaqës të dedikuar ku akseson ose shpërndan informacionin (bazuar tek dokumenti: Ndërfaqja Administrator, Pedagogu, Sekretaria, Studenti.pdf). Npërmjet sistemit “edu4schools” pedagogët ju japin akses studentëve në syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Npërmjet këtij sistemi, i cili përmban platforma të integruara, realizohet komunikimi midis palëve si: administratorit, pedagogëve, studentëve, sekretarisë, etj, sipas kompetencave që e përcakton Rregullorja e UMT. Midis pedagogëve dhe sekretarisë shkëmbihet informacioni për rezultatet e studentëve apo frekuentimin e tyre, apo midis studentëve dhe sekretarisë shkëmbihet informacion për notat, kreditet, etj, si dhe midis pedagogëve dhe studentëve shkëmbihet informacion për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Gjithashtu komunikimi në UMT realizohet npërmjet postës elektronike me adresat e email-it të domain-it umt.edu.al.</p> <p>Npërmjet faqes së web-it të UMT shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në UMT dhe aktivitete të tjera që zhvillohen në institucion.</p> <p>GVJ konstaton se sistemi elektronik i informacionit “edu4schools” ka funksione dhe module të integruara të cilat ju mundësojnë stafit dhe studentëve komunikimin në kohë reale dhe shkëmbimin e dokumentave</p>




	<p>në mbështetje të procesit mësimor. Gjithashtu sistemi ju mundëson drejtuesve të institucionit aksesin në dokumenta apo raporte sipas nevojave të tyre.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 95 Rregullore e Sekretarisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 43 Informacion informatik i menaxhimit të studenteve.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 45 Ndërfaqja Administrator, Pedagogu, Sekretaria, Studenti.pdf</i></p> <p><a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></p> <p><i>Aneksi 36 Publikimi në WEB i të UMT-së i të gjithë noftimeve (linku përkatës).pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të gjitha informacionet e rëndësishme që lidhen me programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion” gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it <a href="https://umt.edu.al/administrim-biznesi">https://umt.edu.al/administrim-biznesi</a>. Këtu gjenden informacione që lidhen me kohëzgjatjen e programit të studimit, numrin e krediteve, planin mësimor, koordinatorin e programit, pedagogët, përgjegjësën e departamentit që ofron këtë program studimi, etj. Gjithashtu në faqen e web-it gjenden aktivitetet e ndryshme të Departamentit të Shkencave të Administrimit apo Fakultetit të Ekonomisë përgjegjës për këtë program studimi, si dhe informacione të tjera që lidhen me UMT.</p> <p>Informacionet janë në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><a href="https://umt.edu.al/administrim-biznesi">https://umt.edu.al/administrim-biznesi</a></p> <p><i>Aneksi 36 Publikimi në WEB i të UMT-së i të gjithë noftimeve (linku përkatës).pdf</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1254 753 1321">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="753 1254 967 1321">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="967 1254 1176 1321">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1321 753 1395"></td> <td data-bbox="753 1321 967 1395"></td> <td data-bbox="967 1321 1176 1395" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

**Standardi IV.6**


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka hartuar planin e detajuar financiar, ku paraqiten kostot e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion” si dhe burimi i të ardhurave për të mbuluar këtë program. Ky plan është dorzuar që në aplikimin për hapjen e programit dhe është pjesë e dokumentacionit për licensimin e tij. Gjithashtu GVJ konstaton se UMT harton dhe miraton buxhetin në përputhje me Statutin,</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë</p>	


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Seksioni VIII, Neni 31. Miratimi i buxhetit bëhet nga Bordi i Administrimit nën drejtimin e Kryetarit të Bordit. Përgatitja e buxhetit bëhet nga administratori në përputhje me parashikime ligjore, Statutin dhe Rregulloren e UMT. Njësitë bazë të UMT paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, pas miratimit në nivelet përkatëse këto kërkesa përcillen në departamentin e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të institucionit si një njësi e vetme.</p> <p>Tabela 18 në dokumentin “Tabelat Bachelor ne Administrim Biznesi me profile” tregon që institucioni harton një raport financiar të kostove të këtij programi studimi, ku vërehet që kostot mbulohej nga të ardhurat e siguruara nga tarifat e studimit të studentëve dhe një pjesë e vogël nga financimi i aksionerëve të shoqërisë.</p> <p>Plani i financimit të programeve të studimit përmban të gjitha zërat që përcakton standardi, të tilla si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative, shpenzime për kërkim &amp; zhvillim, etj. Konstatohet në këtë plan që shpërndarja e detajuar e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucional dhe sipas njësave kryesore, janë bërë duke u mbështetur tek kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 96Buxheti i UMT-së.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Bachelor ne Administrim Biznesi me profile – Tabela 18</i></p> <p><i>Aneksi 115Shpenzimet dhe të ardhurat e FE në 3 vitet e fundit- Tabela nr. 10.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në bazë të dokumentit “Raporti Auditues Pasqyrat Financiare të Vitit 2021” GJV konstaton që institucioni kryen auditimin e përvitshëm me auditues ligjor të pavarur. Në këtë raport paraqiten në mënyrë të hollësishme analiza në lidhje me të ardhurat dhe kostot për studentë duke argumentuar edhe përputhjen e performancës financiare të UMT në lidhje me standardet kontabël të miratuara.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 97Raporti Auditues Pasqyrat Financiare viti 2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentat financiare të dorëzuara në dosjen e vetëvlerësimit, konstaton që UMT dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron. Në bazë rezultateve të raportit të një viti, parashikohen ndërhyrje në buxhetin që miratohet nga bordi i administrimit për vitin pasardhës, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga njësitë bazë apo njësitë kryesore.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 97Raporti Auditues Pasqyrat Financiare viti 2021.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 96Buxheti i UMT-së.pdf</i></p>

	Tabelat Bachelor ne Administrim Biznesi me profile – Tabela 18 Aneksi 115Shpenzimet dhe të ardhurat e FE në 3 vitet e fundit- Tabela nr. 10.pdf			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar tek pasqyrat e raportit financiar si dhe raporti i auditit ligjor të jashtëm GVJ konstaton se UMT dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi, si dhe të programeve të tjera të studimit që ky institucion ofron. Bazuar tek dokumentat (Shpenzimet dhe të ardhurat e FE në 3 vitet e fundit) të ardhurat gjatë 3 viteve të fundit kanë ardhur kryesisht nga “Grantet për kërkim dhe kontratat” si dhe nga “Tarifat për dhe gjatë shkollimit”. Gjatë vitit 2021 të ardhurat janë mbështetur edhe me sponsorizime. Bazuar tek tabelat e buxhetit për 3 vitet e fundit konstatojmë se të ardhurat janë në rritje, që gjë mbështet qëndrueshmërinë financiare të institucionit.  <i>Evidenca</i> Aneksi 97Raporti Auditues Pasqyrat Financiare viti 2021.pdf Aneksi 96Buxheti i UMT-së.pdf Tabelat Bachelor ne Administrim Biznesi me profile – Tabela 18 Aneksi 115Shpenzimet dhe të ardhurat e FE në 3 vitet e fundit- Tabela nr. 10.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në bazë të dokumentave të shqyrtuara GVJ vëren se UMT ka përshkruar qartësisht të gjitha procedurat dhe politikat që djek për të mbuluar ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në dokumentat e mëposhtme:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT;</li> <li>• Rregullore e UMT Kreu III; VI;</li> <li>• Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Kreu III;</li> <li>• Statuti i UMT Kreu V Neni 68-72.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me Ligjin Nr. 80/2015, dhe Udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor.</p> <p>UMT i ofron të gjithë të interesuarve dhe kandidatëve për studentë, informacione të qarta dhe të detajuara në lidhje me kriteret e pranimit dhe procedurat e regjistrimit. Këto informacione mund të merren pranë UMT nëpërmjet broshurave ose takimeve informuese, si edhe në faqen e web-it të UMT (<a href="https://umt.edu.al/pranimet">https://umt.edu.al/pranimet</a>).</p> <p>Në bazë të Rregullores së UMT Neni 15, 16 dhe Statutit të UMT Neni 68, GVJ konstaton se të gjitha procedurat garantojnë barazi, të drejta dhe detyrime të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion” si dhe për të gjithë studentët e tjerë të UMT.</p> <p>Gjithshtu GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e sipërpërmendura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar, nëpërmjet faqes së web-it të UMT <a href="https://umt.edu.al/njoftime-dhe-publikime">https://umt.edu.al/njoftime-dhe-publikime</a>.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><a href="https://umt.edu.al/pranimet">https://umt.edu.al/pranimet</a></p> <p><a href="https://umt.edu.al/njoftime-dhe-publikime">https://umt.edu.al/njoftime-dhe-publikime</a></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 30 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 31 Vendim Rektorati për ngritjen e komisionit për pranimin e kandidateve në ciklin e parë programet e studimit të integruara dhe në ciklin e dytë të studimit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 32 Kuotat e pranimit në programet e UMT, miratuar me VSA, viti akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 33 Kriteret e pranimit në programet e UMT, miratuar me VSA, viti akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 34 Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 35 Procesverbal i Komisionit të pranimit të maturanteve me përlllogaritjen e pikëve dhe rankimin e kandidatëve.pdf</i></p>




	<i>Aneksi 99 Propozimi i Fakultetit për kuotat e pranimit.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në takimin me drejtuesit e institucionit, GVJ u informua që kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit Bachelor në UMT propozohen nga njësia kryesore dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të UMT. Në këtë takim u theksua se për planifikimin e kuotave të pranimit merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastruktura pritëse e institucionit. Vendimet e miratuara për kriteret dhe kuotat i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstaton se UMT përcakton nëpërmjet Statutit Neni 68 dhe Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë Neni 20, se kriteri bazë i pranimit është diploma e shkollës së mesme dhe mesatarja e shkollës së mesme që përcaktohet çdo vit nga MASR. GVJ nuk konstaton kritere specifike për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion", por u informua që në varësi të kuotave të përcaktuara, komisionet ad-hoc të ngritura për shqyrtimin e kandidatëve dhe përzgjedhjen e tyre, bazohen në disa komponentë duke përfshirë rezultatet e ciklit të mesëm të studimeve, llojin e diplomës, etj.
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjithashtu në bazë të dokumentave të sipërpërmendura si dhe Vendimit të Senatit për miratimin e kuotave të pranimeve për vitin akademik 2021-2022, GVJ vëren që institucioni parashikon edhe kuota për studentët e huaj dhe kategori të caktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht për këtë program studimi nuk ka kuota të përcaktuara për studentët të huaj, por ka për programet e tjera të studimit. Ata ndjekin të njëjtën procedurë pranimi dhe regjistrimi të parashikuara në Rregulloren e UMT. Përsa i përket programeve të studimit në gjuhë të huaj që ofrohen nga UMT për studentët vendas dhe të huaj, kandidatët duhet të zotërojnë dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj sipas udhëzimit në fuqi të MASR.  Në fillim të vitit akademik UMT bën publike në faqen e webit ( <a href="https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-bachelor">https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-bachelor</a> ) të gjitha kriteret dhe procedurat e aplikimit për programet e studimit që ofron. Gjithashtu ky informacion shpërndahet edhe nga sektori i marketingut të UMT, apo dhe nga takimet informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mediave të tjera të komunikimit.  <u>Evidenca</u> <a href="https://umt.edu.al/pranimet">https://umt.edu.al/pranimet</a> <a href="https://umt.edu.al/njofitime-dhe-publikime">https://umt.edu.al/njofitime-dhe-publikime</a> <i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i> <i>Aneksi 50 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i> <i>Aneksi 30 Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf</i>




	<p><i>Aneksi 31Vendim Rektorati për ngritjen e komisionit për pranimin e kandidateve në ciklin e parë programet e studimit të integruara dhe në ciklin e dytë të studimit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 32Kuotat e pranimit në programet e UMT, miratuar me VSA, viti akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 33Kriteret e pranimit në programet e UMT, miratuar me VSA, viti akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 34Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 35Procesverbal i Komisionit të pranimit të maturanteve me përllogaritjen e pikëve dhe rankimin e kandidatëve.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 99Propozimi i Fakultetit për kuotat e pranimit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 79Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 20Programet në gjuhën angleze fletëpalose.pdf</i></p> <p><i><a href="https://umt.edu.al/image.ashx?i=1817276.pdf&amp;fn=VSA%20mbi%20kriteret%20e%20pranimit%202023-2024%20ne%20UMT.pdf">https://umt.edu.al/image.ashx?i=1817276.pdf&amp;fn=VSA%20mbi%20kriteret%20e%20pranimit%202023-2024%20ne%20UMT.pdf</a></i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**



<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e UMT, GVJ u informua që institucioni informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Sekretaria mësimore informon studentët për të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin mësimor dhe programin e tyre të studimit. Nëpërmjet sekretarisë ata informohen për oraret, detyrimet akademike, provimet, etj. Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, kërkesat për frekuentimin, etj.</p> <p>Përveç informimit të drejtpërdrejtë nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe pedagogëve, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe të gjithë të interesuarve, informacion të detajuar në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin nëpërmjet Rregullores së UMT Kreu IV Nenet 23 -36 dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznesi me Profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”.</p> <p><i>Evidenca</i></p>




	<p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 58Rregullore e programit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 63Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesëshme janë përshkruar qartësisht në dokumentat: Statuti i UMT Neni 72; Rregullorja e UMT Kreu VI; Rregullorja e FE Neni 22; Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT. Këto procedura ju bëhen të qarta të gjithë studentëve që janë të interesuar të ndjekin studimet në UMT dhe kanë studime apo kualifikime të mëparshme. Për studentët që dëshirojnë të transferohen në të njëjtin program studimi ose të ngjashëm në UMT, institucioni ngrë një komision ad-hoc i cili shqyrton dhe vlerëson dosjen e studentit për të ekuivalentuar kreditet në përputhje me udhëzimet ligjore dhe Rregulloren e UMT. Gjithashtu informacioni është i qartë për të gjithë të interesuarit edhe nëpërmjet faqes së web-it të UMT <a href="https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve">https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve</a>, si dhe mediave të tjera të komunikimit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 50Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 30Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT.pdf</i></p> <p><a href="https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve">https://umt.edu.al/transferimet-e-studimeve</a></p> <p><i>Aneksi 36Publikimi në WEB i të UMT-së i të gjithë noftimeve (linku përkatës).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua që studentët marrin informacionet e para në mjediset e UMT gjatë “Javës së Orientimit” që zhvillohet për ta në fillim të vitit akademik. Të gjithë studentët informohen nga Sekretaria Mësimore, drejtuesit dhe pedagogët për çdo gjë që ata kanë nevojë në lidhje me procesin mësimor, ku përfshihet edhe mënyra e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Siç e përmendëm edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, studentët informohen gjithashtu në fillim të çdo semestri në çdo lëndë, për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës.</p> <p>Të gjitha rregullat për vlerësimin e aftësive dhe dijeve të studentëve janë të përcaktuara qartësisht në dokumentat e shqyrtuara nga GVJ: Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve; Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile Kreu III; Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë Neni 25 - 29; Rregullore e UMT Kreu V. Të gjithë këto dokumenta janë në dispozicion të studentëve të UMT në çdo kohë.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 80Shembull - java e orientimit-FE.pdf</i></p>

	<p><i>Aneksi 56Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 50Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 58Rregullore e programit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 63Procedura për zhvillimin e provimeve FE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në përputhje me Panin Mësimor të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”, studentët informohen për detyrimet përmblylëse të këtij programi ku përfshihet provimi i formimit ose mbrojtja e punimit të diplomës, nëpërmjet të cilit studentët fitojnë 6 kredite ECTS. GVJ kostaton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në UMT përcaktohen në dokumentat: Rregullore e UMT Kreu VII; Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile Neni 17; Rregullore për Punimin e Diplomës. Në to përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbrohet me provim formimi ose temë diplome në përputhje me kurrikulat mësimore të programeve të studimit. Studentët informohen për këtë nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të tretë dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjithë studentët kishin marrë informacionet e nevojshme për të gjithë procesin e diplomimit të tyre, qoftë ata me provim formimi (Rregullore e UMT Kreu VII Neni 58). qoftë ata me temë diplome (Rregullore e UMT Kreu VII Neni 54).</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 58Rregullore e programit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 64Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 55Plani mësimor sipas planit të veprimtarisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit e institucionit GVJ u informua që UMT zhvillon takime informues me studentët e ardhshëm, duke shkuar në institucionet arsimore në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se maturantët të përzgjedhin programet e tyre të studimit UMT organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së marketingut dhe shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësitë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Informimi i publikut bëhet jo vetëm në takimet e drejtpërdrejta informuese, por edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të tilla si fletë palosje, Guidës së UMT, rrjeteve sociale, etj. Gjithashtu gjatë “Javës së Orientimit” studentët e ardhshëm prezantohen me programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor.</p>

	<i>Evidenca</i> <i>Aneksi 79Guida e Studentit.pdf</i> <i>https://umt.edu.al/fakulteti-i-ekonomise</i> <i>Aneksi 80Shembull - java e orientimit-FE.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Në bazë të dokumentave (Plani mësimor i programit: Tabelat përmbledhëse – Tabela 9 dhe 10; Dosja e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile), programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion” ofrohet gjatë 3 viteve akademike në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit studentët pajisen me 180 kredite evropiane ECTS dhe, ju jepet diploma sipas profilit që ata kanë ndjekur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diplomë Bachelor në “Administrim Biznesi” profili “Menaxhim”</li> <li>• Diplomë Bachelor në “Administrim Biznesi” profili “Marketing”</li> <li>• Diplomë Bachelor në “Administrim Biznesi” profili “Sipërmarrje dhe Inovacion”</li> </ul> <p>Për secilin nga profilet, çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë, përkatësisht me 66 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 54 kredite për vitin e tretë. Plani mësimor për të tre profilet përcakton këtë ndarje sipas tipit të veprimtarve formuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 5 lëndë bazë (A) në total 30 kredite</li> <li>• 16 lëndë karakterizuese (B) në total 96 kredite</li> <li>• 5 lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) në total 27 kredite</li> <li>• 4 lëndë plotësuese në total (D) 21 kredite</li> <li>• 1 detyrim përmbyllës diploma (E) 6 kredite</li> </ul> <p>Plani mësimor i programit është hartuar në përputhje me: Statutin e UMT Pjesa IV; Rregulloren e UMT Kreu IV; Rregullore e FE Neni 18. GVJ konstaton se të gjitha informacionet e mësipërme, në lidhje me strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre. Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët GVJ u informua se çdo vit akademik Departamenti i Shkencave të Administrimit së bashku me Dekanin e</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Fakultetit të Ekonomisë organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve me Universitetin, Fakultetin e Ekonomisë dhe programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile. Gjishtashtu studentët informohen në mënyrë të detajuar edhe në fillimit të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore dhe pedagogët për oraret, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, provimet, etj. Secili pedagog në prezantimin e lëndës shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit, materialeve të lëndës, objektivave formuese, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>UMT përdor sistemin e brendshëm të informacionit “edu4schools” që lidh studentin me pedagogun dhe Sekretarinë Mësimore. Nëpërmjet këtij sistemi studentët informohen në lidhje me strukturën e programit që ndjekin, organizimin, kohëzgjatjen e programit, moduleve, lëndëve, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, syllabuset, etj.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 50Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 58Rregullore e programit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 53Dosje e programit. Të dhena të përgjithshme për programin e studimit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 54Plani mësimor tabela 10.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 55Plani mësimor sipas planit të veprimtarisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 56Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 59Modeli i diplomës.pdf</i></p> <p><a href="https://www.edu4schools.gr/Account/Login">https://www.edu4schools.gr/Account/Login</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të shqyrtura (Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës), GVJ u informua që studentët që ndjekin programet e studimit pranë UMT kanë në dispozicion shërbimin e Zyrës së Pranimeve dhe të Këshillimit të Karrierës, e cila ju jep studentëve informacione mbi mundësitë e tyre të punësimit. Gjithashtu kjo zyrë i informon rreth mundësive të ndryshme që institucioni në bashkëpunim me partnerët ofron për trajnimet, aktivitete të ndryshme, internshipe, praktika profesionale, etj. Një burim i mirë informacioni në këtë aspekt është edhe Guida e Studentit apo raporti i hartuar nga studimi i tregut. UMT ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi (Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE) nëpërmjet të cilave krijon urën lidhëse midis studentëve që diplomon dhe tregut të punës.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile, nuk kemi akoma statistika në lidhje me numrin e studentëve të punësuar sepse këtë vit akademik (2021-2022) diplomohet brezi i parë i studentëve.</p>

	<p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 77Rregullore e zyrës së Këshillimit të Karrierës FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 79Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 74Studim tregu për programin.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 22Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit dhe antarësimet në rrjete.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 23Lista e marrëveshjeve në kuader të programeve të FE.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se në UMT studentëve ju jepet një informacion i gjërë dhe i detajuar për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, kohëzgjatjen e studimeve, lëndët, përmbajtjen e tyre, mënyrat e vlerësimit, planin mësimor, etj. Ashtu sikurse e kemi evidentuar edhe më parë në këtë raport, në fillim të vitit akademik zhvillohet “Java e Orientimit” gjatë së cilës çdo departament së bashku me dekanatin organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vit të parë. Gjatë këtyre takimeve studentëve ju jepet informacioni jo vetëm për programet e studimit që ata do të ndjekin, por shpjegohen në detaje edhe struktura e UMT, struktura e fakulteteve përkatëse, prezantohen drejtuesit, bëhet prezantimi i klasave, laboratorëve, bibliotekës, etj. Studenti informohet në lidhje me këto aspekte edhe nëpërmjet materiale të detajuara që ndodhen në dosjen e tij të regjistrimit apo Guidës së studentit, faqes së web-it, fletëpalosjeve, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe në Kriterin 2 të këtij standardi, UMT përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit “edu4schools”, nëpërmjet të cilit studentët informohen për të gjitha aspektet që lidhen me programin e tyre të studimit. Portali i Studentit i lidh ata me Sekretarinë Mësimore dhe pedagogët dhe i jep mundësinë atyre të aksesojnë informacionet edhe në distancë.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 87Shembull-dosje studentë të regjistruar.pdf</i></p> <p><a href="https://www.edu4schools.gr/Account/Login">https://www.edu4schools.gr/Account/Login</a></p> <p><i>Aneksi 43Informacion informatik i menaxhimit të studenteve.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 44Manual përdorimi i sistemit informatik të studenteve.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 45Ndërfaja Administrator, Pedagogu, Sekretaria, Studenti.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 36Publikimi në WEB i të UMT-së i të gjithë noftimeve (linku përkatës).pdf</i></p> <p><i>Aneksi 80Shembull - java e orientimit-FE.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

**Kriteret**

**Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

**Vlerësimi i ekspertëve**

GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore e UMT, disponon dhe mban statistika në lidhje me të dhënat e studentëve për të gjitha programet e studimit, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Udhëzimit të MAS “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore“, Udhëzimin e MAS, Nr. 16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve“. Përkatësisht Sekretaria Mësimore administron Regjistrin Themeltar të studentëve, Regjistrin e Arritjeve Akademike (të notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave.

Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ u interesuar për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile dhe u njoh me këto statistika, që përmbanin të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Përsa i përket këtij programi studimi, ai është licensuar në 22.07.2019, ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2019 – 2020. Këtë vit akademik (2021 – 2022) diplomohen studentë për herë të parë.

Gjithashtu në këtë zyrë gjenden regjistrat e pedagogëve me vlerësimet dhe frekuentimin e studentëve, dokumentacioni që tregon rezultatet e ndërmjetme, proces verbalet e notave, etj. Rezultatet regjistrohen në procesverbalet sipas lëndëve në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 Neni 101. Më pas notat hidhen në regjistrin e notave.

GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë (hard copy) dhe elektronike. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat nëpër regjistrat e sipërpërmendur ishin plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji.

Bazuar në dokumentin: “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi për vitet akademike 2019 - 2022, Tabela 21” tabelat e mëposhtme paraqesin për tre vitet e fundit përkatësisht:

Tabela 1: Numri i të regjistruarve dhe mesatarja përkatëse

Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje
2019-2020	7	7.7
2020-2021	11	7.8
2021-2022	18	8.04

Tabela 2: Numri i studentëve të transferuar dhe atyre të larguar

	Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar
	2019-2020	9	6
	2020-2021	10	2
	2021-2022	1	0

*Evidenca*  
*Aneksi 95Rregullore e Sekretarisë.pdf*  
*Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 21*

**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.


Siç e kemi evidentuar edhe më parë në këtë raport, UMT përdor sistemin e brendshëm elektronik të informacionit “edu4schools”, për të komunikuar midis studentëve dhe njësive përbërëse të institucionit. Aksesin në informacion studentët dhe pedagogët e marrin nëpërmjet Portalit të Studentit si edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në Sekretarinë Mësimore. Sekretaria ruan të dhënat në format elektronik, si dhe në regjistrat fizikë dhe dokumenta të tjera të printuara, të përmendura në Kriterin 1 të këtij standardi. Në të gjitha rastet të dhënat ruhen në mënyrë të sigurtë dhe në përputhje me Statutin e UMT, Neni 104, 105 dhe sipas rastit janë lehtësisht të aksesueshme për këdo që është i autorizuar (studentët, pedagogët, drejtuesit e institucionit, etj).

*Evidenca*  
*Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf*  
*Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf*  
*Aneksi 50Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf*  
*Aneksi 95Rregullore e Sekretarisë.pdf*  
<https://www.edu4schools.gr/Account/Login>  
*Aneksi 111Rregullore e arkivës.pdf*

**Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Siçurse e kemi evidentuar edhe në sipër në kriteret e këtij standardi, institucioni harton nëpërmjet Sekretarisë Mësimore raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve të programeve të studimit që ai ofron. Përkatësisht për këtë program studimi janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur edhe në dokumentin: “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi për vitet akademike 2019 - 2022, Tabela 21” .

Gjithashtu Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shërbimit ndaj Studentit dhe Alumni analizon gjendjen e punësimit të studentëve dhe bën raportet përkatëse. Këto raporte hartohen në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në shërbim të njësive dhe drejtuesve të institucionit për të realizuar analizat vjetore. Këto analiza i gjejmë në dokumentat: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi për vitet akademike 2019 - 2022, Tabela 21; Raport Vjetor







	<p>viti akademik 2020 – 2021. Në Raportin Vjetor të paraqitur në njërin nga seksionet janë diskutuar edhe problematika të ndryshme të hasura dhe janë dhënë propozime për zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 21</i></p> <p><i>Aneksi 74Studim tregu për programin.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 81Lista e studentëve Alumni.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 81Lista e studentëve Alumni.pdf</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të Statutit të UMT Neni 10, 29, 103, studentët përfaqësohen me pjessmarrjen e tyre në këto organe vendimmarrëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senati Akademik – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor</li> <li>• Këshillat studentorë – sipas njësave kryesore</li> <li>• Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor (presidenti i qeverisë studentore)</li> </ul> <p>Këshilli studentor i UMT është organ kolegjal, përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Ai zgjidhet çdo dy vjet në mënyrë demokratike dhe është organi më i rëndësishëm i studentëve cili përfaqëson dhe mbron interesat e tyre. UMT mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimtaritë e tyre nga fondi i caktuar për këto qëllime nga buxheti vjetor. Nëpërmjet këshillit studentor studentët janë të ftuar të marrin pjesë në projekte e aktivitete shkencore e sociale të institucionit. Në bashkëpunim me fakultetet dhe strukturat e tjera të UMT, këshilli studentor organizon gjithashtu Konferencën Studentore.</p> <p>Në takimin që u zhvillua me studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile, GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit, p.sh. një kërkesë e tillë është e paraqitur në dokumentin “Kërkesa të Këshillit Studentor” të</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>cilës i është përgjigjur Zyra e Mardhënieve me Studentët - Shërbimi ndaj Studentit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 7 VSA për ngritjen së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 8 Përbërja e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 12 Anketa për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 106 Kërkesa të ndryshme të Këshillit Studentor të FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 105 Rregullore e Senatit Studentor UMT.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 104 Aktivitete të kryera nga studentët- qeveri studentore UMT-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 84 Aktivitete sociale artistike për studentët e FE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ashtu sikurse e kemi evidentuar edhe në Standardin V.3, ky program studimi ka një ngarkesë akademike të shtrirë në 3 vite akademike në përfundim të të cilit studentët marrin 180 kredite ECTS. Për secilin nga profilet, çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë, përkatësisht me 66 kredite për vitin e parë, 60 kredite për vitin e dytë dhe 54 kredite për vitin e tretë. Kreditet minimale europiane për një lëndë janë 3 ECTS dhe maksimale 6 ECTS. Ka një shpërndarje të numrit të orëve në auditor plus studimin individual përkatësish: 1650 orë për vitin e parë, 1500 orë për vitin e dytë dhe 1350 orë për vitin e tretë (Plani mësimor i programit: Tabelat përmbledhëse – Tabela 10). Kjo shpërndarje është e balancuar dhe lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga institucione të tjera ose drejt UMT. GVJ konstaton se hartimi i Planit Mësimor të këtij programi është bërë në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>Sikurse është evidentuar edhe në standardet e mësipërme, kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesëshme hartohen dhe zbatohen në përputhje me Rregulloren e UMT, Kreu V dhe VI. GVJ konstaton që këto procedura janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Tabelat Permbledhese.pdf – Tabela 10</i></p> <p><i>Aneksi Nr.02 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimin të programeve të studimit në UMT bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë sugjerimet dhe kërkesat e studentëve përcillen nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse të institucionit, të tilla si Senati Akademik apo NJBSC. Gjithashtu kërkesat e tyre përcillen në të gjitha nivelet</p>

	<p>drejtuese nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, këshilltarëve akademikë dhe koordinatorit të programit.</p> <p>Në mënyrë të tërthortë sugjerimet dhe opinionet e studentëve, jepen nëpërmjet pyetsorëve periodikë në fund të çdo semestri, dhe shërbejnë për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Raportet e hartura nga përpunimi i këtyre pyetsorëve zënë një pjesë të rëndësishme të diskutimit në mbledhjet e dekanatit dhe departamenteve në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit në tërësi.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 10 Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 11 Model pyetësori për studentët (Anketa).pdf</i></p> <p><i>Aneksi 114 Minuta mbledhje departament dekanat - FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 76 Minuta të mbledhjeve të Dekanatit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 71 Model i formularit të vlerësimit të performances.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT nëpërmjet Rregullores së Provimeve ka përcaktuar qartë procedurat që lidhen me zhvillin e provimeve, sekretimin, mënyrën e vlerësimit, procesin e ankimit, përmirësimin e notës, etj. Këto informacione janë të qarta edhe për studentë, të cilët informohen nëpërmjet pedagogëve të lëndëve, si dhe kanë akses në këtë Rregullore.</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se atyre ju jepet mundësia të vlerësojnë performancën e pedagogëve në të gjitha aspektet e procesit mësimor, që nga procesi i mësimdhënies deri tek vlerësimi. Studentët njihen me rezultatet e marra gjatë semestrit përpara provimit, dhe me rezultatin e provimit tre ditë pas zhvillimit të provimit. Ata pohuan se ju jepet e drejta të ankimojnë rezultatin e marrë të provimit, me një kërkesë me shkrim. Komisioni i provimit pret çdo reagim të studentit dhe e ballafaqon atë me provimin e tij. Në përfundim të procesit sqarues komisioni bën vlerësimin përfundimtar. Në rast se studenti nuk është dakord me vendimin e këtij komisioni ka të drejtë të kërkojë ngritjen e një komisioni shqyrtues nga departamenti përkatës i programit të tij të studimit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 101 Rregullore e Provimeve.pdf</i></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**



Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: 355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara si dhe informacioneve të marra nga vizita në institucion, GVJ konstaton se UMT ka këto njësitë në shërbim të studentëve, për informimin dhe këshillimin e tyre, si dhe për ndjekjen e përparimit akademik nga hyrja në dalje:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra e pranimit dhe këshillimit të karrierës</li> <li>• Zyra e shërbimit ndaj studentit dhe alumni</li> <li>• Këshilltari akademik</li> <li>• Përgjegjësit/koordinatorët e programeve</li> <li>• Sekretaria mësimore</li> </ul> <p>Zyra e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës u vjen në ndihmë të gjithë studentëve me informacione mbi programet e studimit, mundësitë e bursave, informimin për aktivitetet në institucion, informacione për mundësitë e punësimit, praktikat apo trajnimet në institucione të ndryshme.</p> <p>Zyra e Shërbimit ndaj Studentit dhe Alumnit organizon aktiviteteve studentore, krijimin dhe mbarëvajtjen e klubeve studentore, asiston në punën e Qeverisë Studentore, ruan marrëdhëniet me studentët e diplomuar, etj.</p> <p>Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve, arkivimin e dokumentacionit të tyre, pajis studentët me dokumente të ndryshme që mund t'u nevojiten si lista notash apo vërtetime, administron sezonet e provimeve që nga sekretimi i tezave, publikimi i rezultateve të provimeve, procesin e ankimimit, etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka Departamenti i Shkencave të Administrimit dhe Këshilltari Akademik i caktuar për këtë program studimi, i cili ndihmon studentë për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me procesin mësimor dhe i adreson ato në departament.</p> <p>Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet portalit “edu4schools” si, faqes së web-it dhe Guidës së studentit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 50 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 95 Rregullore e Sekretarisë.pdf</i></p> <p><i><a href="https://www.edu4schools.gr/Account/Login">https://www.edu4schools.gr/Account/Login</a></i></p> <p><i>Aneksi 79 Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i><a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></i></p> <p><i>Aneksi 98 Detyrat dhe përgjegjësit e Këshilltarit Akademik.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sikurse u cilësua edhe në kriterin 1 dhe 2 të këtij standardi, Zyra e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës është njësia që mirëpret studentët duke ju ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me karrierën, praktikat profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Kjo zyrë bashkëpunon me departamentet për organizimin e praktikave profesionale, organizon panairët e punës, mban mardhënie me Alumni dhe i mbështet në organizimet e tyre, i ofron studentëve mundësi për bursa të ndryshme, mundësi për ndjekjen e shkollave verore, organizon workshop-e, trajnime, etj.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Përsa i përket statistikave për numrin e studentëve të diplomuarve në këtë program studimi, sikurse e kemi evidentuar edhe më parë në këtë raport, deri në momentin kur është kryer vizita në institucion nuk kemi akoma të diplomuar, meqë në këtë vit akademik përfundon brezi i parë i studentëve. GVJ u informua që kjo zyrë në përgjithësi, për të gjitha programet e studimit që ofrohen në UMT, mbledh informacione mbi të diplomuarit dhe përgatit raporte për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 77Rregullore e zyrës së Këshillimit të Karrierës FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 74Studim tregu për programin.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 81Lista e studentëve Alumni.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 82Rrjeti Alumni.pdf</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në</p>	<p>GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UMT. Kjo njësi është përgjegjëse për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në bazë të Statutit të UMT, NJSBC është një organ kolegjal, nën varësinë e Rektorit. Ajo përbëhet nga 6 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të personelit akademik efektiv (PAE) të njëjësive kryesore, 1 përfaqësues i këshillit studentor, 1 ekspert i jashtëm dhe 1 përfaqësues i administratës. Kjo njësi funksionon në bazë të Statutit të UMT Neni 29 – 30 dhe Rregullores së NJSBC. NJSBC zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ajo monitoron cilësinë e mësimdhënies, bën vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p>GVJ konstaton se NJSBC në UMT funksionon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe aktet rregullatore institucionale.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 7 VSA për ngritjen së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 8 Përbërja e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT përdor instrumentat e duhura të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe është vlerësuar pozitivisht për pesë vite, me Vendim Nr.17 të Bordit të Akreditimit më datë 15.12.2017. Gjithashtu janë akredituar një sërë programesh studimi që ky institucion ofron.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”, ky program po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë, pasi është licensuar me Urdhër të MASR Nr. 397, datë 22.07.2019. Sipas dokumentit të hapjes, programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2019-2020.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 13Vendim Akreditimi institucional të UMT nga Bordi i Akreditimit dhe Certifikata e Akreditimit.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 53Dosje e programit. Të dhena të përgjithshme për programin e studimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të Rregullores së NJSBC, se kjo njësi ka këto funksione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• anketimin e studentëve dhe pedagogëve,</li> <li>• hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetorët,</li> <li>• përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj.</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Politikat e punës së NJSBC lidhen me monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e programeve të studimit (kurrikulave) si dhe vlerësimin e programeve të lëndëve (syllabuseve). Nëpërmjet këtyre politikave dhe procedurave periodike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, synohet përmirësimi i programeve të studimit në rang institucional.</p> <p>Në bazë të dokumentit “Politika të zhvillimit të cilësisë në UMT” qasja e cilësisë në UMT bazohet në ciklin “planifiko-bëj-kontrollo-vepro”. Në lidhje me këtë cikël është planifikuar sistemi i aktiviteteve për cilësinë që drejtohet nga NJSBC. Në bazë të aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të monitorimit të cilësisë, NJSBC përgatit në fund të vitit akademik një raport vjetor në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ky raport analizohet në mbledhjet e njësisë kryesore dhe njësisë bazë për të reflektuar mbi nevojat e mundëshme për përmirësimin e programeve të studimit në UMT.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 70 Politika e zhvillimit të cilësisë në UMT.pdf</i>  <i>Aneksi 10 Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësisë të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Sikurse e cilësuam edhe në Standardin VI.1, NJSBC është njësi e ngritur në UMT përgjegjëse për monitorimin dhe rishikim e programeve të studimit. Ajo është pjesë e Rektoratit të UMT dhe varet nga Rektori. Kjo njësi bën në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të cilësisë në njësitë kryesore dhe programet e studimit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek Rektori. Më pas raportet i dërgohen njësisë bazë për të marrë vendime për rishikimin e syllabuseve apo kurrikulave të programeve të studimit.</p> <p>GVJ u informua që përmirësimi i programeve të lëndëve mund të iniciohet edhe nga pedagogët, të cilët mund të bëjnë ndryshime deri në masën 20%. Nëse ndryshimet që kërkohen janë më të mëdha, këto kërkohen nëpërmjet koordinatorit të programit të studimit ose përgjegjësit të departamentit në dekanat.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 50 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i>  <i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p>

	<p><i>Aneksi 42Shembull Plan për rishikimin e planeve mësimore.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 90Shembull- Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sikurse u cilësua edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, pedagogët mund të bëjnë ndryshime në kuadër të përmirësimit të syllabuseve të lëndëve deri në masën 20%. Gjithashtu në fillim të çdo viti akademik atyre ju kërkohet përditësimi i syllabuseve, apo të bëjnë edhe propozime, nëse kanë, për ndryshime më të mëdha, të cilat më pas diskutohen në departamentet përkatëse. Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit në tërësi shërben edhe analiza e pyetsorëve të studentëve që realizohet nga NJSBC.</p> <p>Në lidhje me monitorimin e performancës së programeve të studimit, mekanizmat kryesorë që përdor NJSBC për mbikëqyrjen e tyre dhe të procesit mësimor janë: pyetsori i studentëve për zhvillimin e mësimi, pyetsori i studentit për vlerësimin e kursit, si dhe formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik. Përpunimi i të dhënave të pyestorëve bëhet mbi një metodologji të caktuar, me anë të të cilës janë hartuar pyetjet në seksione që synojnë monitorimin dhe vlerësimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mësimdhënies, kontrollit të dijeve, dhe vlerësimit</li> <li>• materialeve mësimore</li> <li>• mbështetjes së strukturave akademike dhe administrative</li> </ul> <p>Ndërsa përsa i përket monitorimit të performancës në rang institucional, NJSBC e ka përqëndruar punën në këta indikatorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• cilësia në hyrje e studentëve</li> <li>• arritjet dhe suksesi i studentëve</li> <li>• cilësia dhe punësimi i të diplomuarve</li> <li>• vlerësimi i kurrikulës akademike</li> <li>• cilësia e kërkimit</li> <li>• cilësia e botimeve</li> <li>• cilësia e shërbimeve</li> <li>• menaxhimi i financave</li> <li>• përdorimi efektiv i burimeve dhe kapaciteteve</li> <li>• kënaqësia e studentëve</li> <li>• kënaqësia e punonjësve</li> </ul> <p>Treguesit e performancës në vijimësi analizohen nga NJSBC. Në bazë të rregullores së saj, NJSBC i dërgon raportet në Rektorat, dhe më pas ato dërgohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë ku vijohet me planin e masave për të përmbushur rekomandimet e bëra</p> <p>Në raportin e hartuar nga NJSBC për vitin akademik 2021 – 2022 (Rezultatet e Vlerësimit të Procesit të Mësimdhënies - Viti Akademik 2021 – 2022, Semestri I) mbështetur në rezultatet e marra nga përpunimi i të dhënave të pyestorëve të studentëve, ka rezultuar si kërkesë kryesore e studentëve nevoja për rritjen e bashkëveprimit pedagog-student gjatë orës së mësimi. GVJ u informua në takimin me</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	





	<p>përgjegjës in e Departamentit të Shkencave të Administrimit që problematikat e ngritura janë adresuar në mbledhjet e departamentit.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 10</i> Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</p> <p><i>Aneksi 11</i> Model pyetësori për studentët (Anketa).pdf</p> <p><i>Aneksi 42</i> Shembull Plan për rishikimin e planeve mësimore.pdf</p> <p><i>Aneksi 76</i> Minuta të mbledhjeve të Dekanatit.pdf</p> <p><i>Aneksi 114</i> Minuta mbledhje departament dekanat - FE.pdf</p> <p><i>Aneksi 113</i> Formular dhe procesverbali i kontrollit në auditor nga departamenti.pdf</p> <p><i>Aneksi 90</i> Shembull- Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf</p> <p><i>Aneksi 85</i> Forme pyetësori student.pdf</p> <p><i>Aneksi 71</i> Model i formularit të vlerësimit të performances.pdf</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>NJSBC kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në UMT. Ky vlerësim bazohet mbi monitorimin dhe vlerësimin e një sërë indikatorësh të performancës të cilësuar në Standardin VI.2 të këtij raporti. Një vend të rëndësishëm në vlerësimin e brendshëm zë analiza e pyetësorëve të studentëve për procesin mësimor, e cila bëhet çdo semestër. Gjithashtu në këtë vlerësim bën pjesë edhe analiza e të dhënave që merren nga pyetësi i stafit akademik që mat realizimin e objektivave të performancës së tij. NJSBC harton raporte vjetore bazuar mbi këto të dhëna (dokumenti: Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies – viti akademik 2021 – 2022) duke i përfshirë gjithashtu në dosjen e vetë vlerësimit për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi me profile “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”.</p> <p>Në bazë të Rregullores së NJSBC ajo përdor instrumenta të ndryshëm për vlerësimin e cilësisë së programit dhe mbarëvajtjes së tij, instrumenta të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këto instrumenta janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli dhe vlerësimi i syllabuse në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik, vlerësimin e materialeve didaktive, etj.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në</p>	


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: 355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi dhe shpërndarja e “Formularit të vlerësimit të performancës së stafit akademik” nëpërmjet të cilit vlerësohen hartimi i leksioneve të reja, përditësimi i syllabusit dhe literaturës, niveli i kërkimit shkencor, etj.</li> <li>• Monitorimet e drejtpërdrejta gjatë procesit të mësim, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj.</li> </ul> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 10Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 90Shembull- Plan monitorimi për mësimdhënien.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 11Model pyetësori për studentët (Anketa).pdf</i></p> <p><i>Aneksi 85Forme pyetësori student.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 71Model i formularit të vlerësimit të performances.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 113Formular dhe procesverbali i kontrollit në auditor nga departamenti.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se metodat e tërthorta që NJSBC përdor në kuadër të vlerësimit të performancës së programeve të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vjelja e opinioneve të studentëve nëpërmjet “pyetësorit të studentëve”;</li> <li>• analizimi i të dhënave të marra nga “formulari i stafit akademik” që mat realizimin e objektivave të performancës së stafit akademik</li> </ul> <p>Gjithashtu një tjetër instrument është edhe pyetësori që realizohet me studentët e diplomuar. Siç e kemi përmendur edhe në Standardin V.6 të këtij raporti, Zyra a Karrierës grumbullon informacione mbi të diplomuarit dhe mban kontakte me ta. Kjo zyrë merret me realizimin e anketave për studentët e punësuar dhe përgatitjen e raporteve për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 10Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 11Model pyetësori për studentët (Anketa).pdf</i></p> <p><i>Aneksi 71Model i formularit të vlerësimit të performances.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 77Rregullore e zyrës së Këshillimit të Karrierës FE.pdf</i></p>


	<i>Aneksi 74 Studim tregu për programin.pdf</i> <i>Aneksi 81 Lista e studentëve Alumni.pdf</i> <i>Aneksi 82 Rrjeti Alumni.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka siguruar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sistemin e vet të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të programeve të studimit. Sikurse është evidentuar edhe në standardin VI.1, në bazë të Statutit të UMT, si dhe për të pasur një përfshirje sa më të gjërë të të gjithë aktorëve, në strukturën e NJSBC janë përfshirë anëtarë përfaqësues të njëjësive kryesore, përfaqësues të administratës, përfaqësues të studentëve si dhe një ekspert i jashtëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjerë të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja e NJSBC Neni 8 - 14 ka të përcaktuar në detaje detyrat konkrete dhe përgjegjësitë e kryetarit të NJSBC dhe të secilit anëtar sipas kategorive: përfaqësues i fakultetit PAE; përfaqësues i administratës; përfaqësuesi i studentëve. Përveç anëtarëve të NJSBC që kanë detyra të përcaktuara, GVJ u informua se institucioni parashikon dhe përfshirjen e aktorëve të tjerë që nga stafi akademik, ai administrativ, partnerët me të cilët bashkëpunon, alumni, etj, prej të cilëve merr sugjerime për përmirësimin e cilësisë së programeve që ofron.</p> <p><u>Evidenca</u></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 7 VSA për ngritjen së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 8 Përbërja e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni garanton përfshirjen e drejtpërdrejtë të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, të personelit administrativ si dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë duke i përfshirë ata në strukturën e NJSBC. Kjo njësi bashkëpunon me përgjegjësin e departamentit dhe koordinatorin e programit të studimit për realizimin e pyetësorëve të stafit dhe studentëve. Nëpërmjet pyetësorëve apo edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët dhe pedagogët japim mendime dhe sugjerime për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimet me pedagogët dhe studentët, GVJ u informua se anëtarët e NJSBC kanë respektur integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Gjatë zhvillimit të pyetsorëve është ruajtur anonimati, dhe integriteti akademik. Parimet e etikës janë të sanksionuara në Kodin e Etikës së UMT të cilat janë të detyrueshme për të gjithë aktorët.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 7 VSA për ngritjen së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 8 Përbërja e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 14 Rregullore e Etikës.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër në Kriterin 1-2 të këtij standardi, sipas Vendimit të Senatit Akademik për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC në përbërje të saj ka edhe një anëtar ekspert të jashtëm. Sipas Rregullores së NJSBC, të gjithë anëtarët e tjerë të saj kanë detyra të përcaktuara. GVJ konstaton se në Rregulloren e NJSBC roli dhe detyrat e ekspertit të jashtëm nuk janë të përcaktuara qartë. GVJ sugjeron një pjesmarrje më evidente të këtij anëtari duke dhënë një kontribut konkret në përputhjen e këtij programi studimi me nevojat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 7 VSA për ngritjen së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 8 Përbërja e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 9 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Organizimi dhe veprimtaria e NJSBC është përcaktuar në Rregulloren e NJSBC së UMT, ndërsa politikat dhe strategjitë që ajo ndjek në funksion të përmirësimit dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit janë të përcaktuara në dokumentin “Politikat e Cilësisë në UMT”. Këto dokumenta dhe të gjithë ato që lidhen me instrumentat që NJSBC</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:ë355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>përdor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë vënë në dispozicion të GVJ në kuadër të procesit të akreditimit të programit të studimit Bachelor në Administrim biznesi me profile. Gjithashtu GVJ u informua gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC se kjo njësi i bën transparente raportet që harton dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve në institucion (personelit dhe studentëve). Këto raportet përcillen në institucion nëpërmjet njësive bazë tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare. Pavarësisht se e gjithë veprimtaria e NJSBC është e njohur për studentët dhe stafin e UMT, GVJ sugjeron publikimin e të gjithë dokumentave që lidhen me veprimtarinë e NJSBC në faqen zyrtare të web-it në mënyrë që të gjithë të interesuarit të njihen me të.</p> <p>Përsa i përket shpërndarjes në të gjitha nivelet brenda institucionit, të rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit që NJSBC realizon, GVJ konstaton se ato bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 73Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 10Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf</i></p> <p><i><a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në bazë të dokumentit “Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies – viti akademik 2021 – 2022”, konstatohet që NJSBC ka hartuar raportin bazuar tek të dhënat e nxjera nga anketimet e studentëve. Në këtë raport janë evidentuar disa kërkesa kryesore të studentëve dhe janë dhënë disa rekomandime, në kuadër të përmirësimit të procesit mësimor në tërësi, por edhe të zhvillimit të anketimeve dhe pjesmarrjes së studentëve në to. Theksohet në këtë raport që “duhen gjetur mënyra për ti bindur studentët se informacioni që ata përcjellin nëpërmjet pyetësorëve është i dobishëm dhe merret në konsideratë nga autoritetet e UMT (një raport i shkurtër mund ti bëhet i njohur senatit të studentëve, apo të futet në faqen e internetit të UMT)”. <i>Pra rekomandohet një shpërndarje më e gjerë e informacionit edhe në web, si dhe ndërgjegjësim i studentëve për të marrë pjesë në anketim.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me Përgjegjës të Departamentit të Shkencave të Administrimit, si dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ u informua se raportet e NJSBC janë analizuar në mbledhjet e departamentit, dhe janë marrë masa për zgjidhjen e problematikave të hasura. Kjo gjë evidentohet edhe në dokumentin “Plani i punës për veprimtaritë e Fakultetit të Ekonomisë për vitin akademik 2021 – 2022”.</p> <p>GVJ konstaton se NJSBC monitoron cilësinë nëpërmjet mekanizmave të saj, ndërsa departamentet luajnë një rol kyç në kontrollin e zbatimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:ë355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>të masave të marra në kuadër të sigurimit të cilësisë duke u munduar që të sigurojnë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 73 Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi 10 Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit Akademik rezultatet e vlerësimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Shkencave të Administrimit se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin dhe studentët për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>Megjithatë ashtu sikurse është evidetuar edhe në Raportin e NJSBC për vitin 2021 – 2022 duhet një ndërgjegjesim më i madh i studentëve dhe të inkurajohen ata për një pjesmarrje më të madhe në anketim. Për këtë kërkohet edhe një publikim i informacionit që lidhet me proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në faqen e web-it të institucionit.</i></p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>Aneksi 73 Raport vjetor I aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar-FE.pdf</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi" me profile Menaxhim, Marketing, Sipërmarrje dhe Inovacion të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**


1. UMT ka një personel akademik shumë të kualifikuar, të shkolluar brenda dhe jashtë vendit, si dhe me eksperiencë disa vjeçare në mësimdhënie.
2. UMT ofron një mjedis miqësor për studentët dhe mbështetje maksimale për ta.
3. UMT i mundëson studentëve kushte të favorshme për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe pjesmarrje në aktivitete të ndryshme të cilat i lidhin ata me tregun e punës.
4. UMT ofron mjedise mësimore bashkëkohore të pajisura me mjetet e duhura të teknologjisë së informacionit.

**Pika të dobta:**

1. Pjesmarrja e studentëve në anketimin për vlerësimin e performances së stafit akademik është relativisht e ulët. **(Standardi VI.5, kriteri 4)**
2. Numri i ulët i studentëve në këtë program studimi bën që ndarja në profile të jetë e paaplikueshme, ose përndryshe kostot e programit do të jenë shumë të larta. **(Standardi V.4, kriteri 3)**

**Rekomandime:**

1. Rekomandohet një ndërgjegjesim më i madh i studentëve dhe të inkurajohen ata për një pjesmarrje më të madhe në anketimin e vlerësimit të performancës së stafit akademik. Gjithashtu të publikohen informacionet që lidhet me proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në faqen e web-it të institucionit.
2. Rekomandohet shtimi i ofertave akademike në këtë program studimi në mënyrë që të mundësohet shtimi i numrit të studentëve gjithashtu.



**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Business Administration" with profiles Management, Marketing, Entrepreneurship and Innovation of the Higher Education Institution "Metropolitan Tirana University".**

**Strengths and affirmations:**



1. UMT has a highly qualified academic staff, educated at home and abroad, as well as with several years of teaching experience.
2. UMT provides a friendly environment for students and maximum support for them.
3. UMT provides students with favorable conditions for the development of professional practices as well as participation in various activities that connect them with the labor market.
4. UMT offers modern learning environments equipped with appropriate information technology tools.

**Weaknesses:**

1. The participation of students in the survey for the evaluation of the performance of the academic staff is relatively low. **(Standard VI.5, criterion 4)**
2. The number of students in this study program is very low, this makes the division into profiles inapplicable, otherwise the costs of the program will be too high. **(Standard V.4, criterion 3)**

**Recommendations:**

1. A greater awareness of students is recommended and to encourage them for greater participation in the academic staff performance evaluation survey. Information related to the internal quality assurance processes should also be published on the institution's website.
2. It is recommended to increase the academic offers in this study program in order to enable the increase in the number of students as well.





Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

